



**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**  
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**

**PROJEKTI PËR INTEGRIMIN URBAN DHE ZHVILLIMIN E TURIZMIT**

HUA NGA IBRD: NR. 8656- ALB

**FINANCIM I BANKËS BOTËRORE**

(Kjo Procedurë do të udhëhiqet nga Udhezuesit e Bankës Botërore për prokurimin e huave të IBRD-së dhe kredive të IDA-s)

**Dokumenta Tenderi të harmonizuara për  
prokurimin e punimeve civile**

**“Rehabilitimi i rrugës hyrëse "Mihal Komneno" për  
në Kala dhe Tabja”**

**Referencë: FSHZH/ PIUTD/IBRD-NCB-01-2017**

**9 Maj 2017**

**Dokumenta Tenderi  
Punime Civile**

# “Rehabilitimi i rrugës hyrëse “Mihal Komneno” për në kala dhe Tabja”

## I. NJOFTIMI I KONTRATËS

### Seksioni 1 Autoriteti Kontraktor

#### 1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri: **Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)**  
Adresa: **Rruga: “ Sami Frashëri”, Nr. 10, Tiranë**  
Tel: **+355 4 2235 597/8**  
Fax: **+355 4 2234 885**  
E-mail: **eqirjaqi@albaniandf.org**  
Adresa e Internetit: [www.albaniandf.org](http://www.albaniandf.org)

#### I.2 Lloji i autoritetit kontraktor:

Institucion qëndror	Institucion i pavarur
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Njesi e Qeverisjes Vendore	Tjetër
<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

#### 1.3 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një Shteti tjetër

Po  Jo

### Seksioni 2 Objekti i kontratës

#### 2.1 Lloji i Kontratës

Punë	Shërbime	Mallra
<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

#### Lloji i “Kontratave për punë publike”

Realizimi i punëve	Projektimi dhe realizimi i punëve
<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

#### 2.1.2 Kontratë në bazë të Marrëveshjes së Financimit të huasë no. 8656- ALB. , nga Banka Botërore

Po  Jo

#### 2.1.3 Lloji i Marrëveshjes Kuadër: i pa aplikueshëm

**Me 1 Operator Ekonomik**

**Me disa operatorë ekonomikë**

**Të gjitha kushtet janë të përcaktuara** **Po**  **Jo**

#### **2.1.4 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të përfundojë Kontrata:**

Një operator i vetëm ekonomi që ofron cmimin më të ulët, plotëson specifikimet e kërkesat teknike dhe është i kualifikuar për të kryer punimet civile të kërkuara sipas dokumentave të tenderit.

<b>2.1.5</b>	Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike.	i pa aplikueshëm
--------------	---	------------------

#### **2.1.6 Autoriteti kontraktor:** Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)

### **2.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës**

1. Fondi limit: **I pa shpallur**
2. Burimi i Financimit : **Finacim i Bankës Botërore, Hua no. 8656- ALB**
3. Objekti i kontratës : **"Rehabilitimi i rrugës hyrëse "Mihal Komneno" për në kala dhe Tabja"**

### **2.3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**

Kohëzgjatja në **muaj 8 (tetë)**

ose

duke filluar nga / /  me përfundim në / /

#### **2.3.1 Kohëzgjatja e Kontratës: muaj 8 (tetë)**

### **2.4 Vendndodhja e objektit të kontratës:**

Rruga hyrëse "Mihal Komneno" për në kala dhe Tabja – Berat"

### **2.5 Ndarja në LOTE:**

Po  Jo  **X**

*Nëse po,*

### **2.6 Përshkrim i shkurtër i loteve - i pa aplikueshëm**

(Objekti dhe fondi limit i loteve)

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë

## 2.7 Opsionet:

Numri i rinovimeve të mundshme (nëse ka): **JO**

Ose: nga  në

## 2.8 Do të pranohen variantet:

Po	<input type="checkbox"/>	Jo	<input checked="" type="checkbox"/>
----	--------------------------	----	-------------------------------------

### 2.8.1 Do të pranohet nenkontraktimi:

Po  x Jo

**Nese do te lejohet nenkontraktimi**, te specifikohet perqindja e lejuar per nenkontraktim:

Autoriteti kontraktor do t'i beje pagesa te drejperdrejte nenkontraktorit: i pa aplikueshem

Po  Jo

## Shenime te tjera

---

---

---

## Seksioni 3 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

3.1 Kriteret e kualifikimit dhe te Pranimit sipas Shtojcës 10.

3.2 Sigurimi i ofertës:

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, sipas Shtojcës 3. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është **4,135,000 Lekë (kater milion e treqind e tridhjetë e pese mije lekë)**.

## Seksioni 4 Procedura

4.1 Lloji i procedurës: Tender i hapur

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët i ofruar nga oferta e përgjegjeshme që plotëson kriteret e kualifikimit dhe është në përputhje me specifikimet teknike **X**

**4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

Data: **19.06.2017** , Ora: **11:00**

Vendi: **Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)**

Kati: **Kati i 5 (peste)**

Personi i Kontaktit: **Z. Erik Qirjaqi**

**Z. Artur Zaja**

Adresa **Rruga:” Sami Frashëri”, Nr. 10, Tiranë**

**4.4 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

Data: **19.06.2017** , Ora: **11:00**

Vendi: **Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), Kati i 5 (peste)**

Personi i Kontaktit: **Z. Erik Qirjaqi**

Adresa **Rruga:” Sami Frashëri”, Nr. 10, Tiranë**

**Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike duhet t’i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.**

**4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave:** 90 ditë nga dita e hapjes së ofertave

**4.6 Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

Shqip  X Anglisht

Tjetër \_\_\_\_\_

**Seksioni 5 Informacione plotësuese**

**5.1 Dokumenta me pagesë** (i zbatueshëm vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):

Po  x Jo

*Nëse Po*

Monedha **Lekë** Çmimi **25,000**

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DT tek Operatorët Ekonomik. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DT para blerjes së tyre.

Pagesa do të kryhet nepermjet Bnakes me të dhenat e meposhteme dhe ne favor te :

Emri i llogarise: **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**

Emri i Bankes: **Union Bank**

Emertimi i llogarise: **“Llogari Projekti ADF”**

Numri i klientit: **285464**  
IBAN CODE: **AL80 2141 1106 0111 2854 6403 0117**

## **5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)**

Emri i Institucionit: **Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)**  
**Z. Artur Zaja – Specialist Prokurimi**  
Adresa **Rruga :” Sami Frashëri”, Nr. 10, Tiranë**  
Tel **+355 4 2235 597/8**  
Fax **+355 4 2234 885**  
E-mail **eqirjaqi@albaniandf.org**  
E-mail **azaja@albaniandf.org**  
Adresa e Internetit: **<http://www.albaniandf.org>**

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **09.05.2017**

**Njoftimi i kontrates për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor , i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike**

**1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri i Institucionit: **Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)**  
Personi i Kontaktit: **Z. Erik Qirjaqi**  
Adresa **Rruga:" Sami Frashëri", Nr. 10, Tiranë**  
Tel **+355 4 2235 597/8**  
Fax **+355 4 2234 885**  
E-mail **eqirjaqi@albaniandf.org**  
Adresa e Internetit: **<http://www.albaniandf.org>**

**2. Lloji i procedurës se prokurimit: Tender i Hapur**

**3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: "Rehabilitimi i rrugës hyrëse "Mihal Komнено" për në kala dhe Tabja"**

**4. Fondi limit: i pa shpallur**

**5. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 8 (tetë) muaj**

**6- Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Data: 19.06.2017, Ora: 11:00**

**7- Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Data: 19.06.2017, Ora: 11:00**

## II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË

### Seksioni 1. Hartimi i ofertës

1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

1.2 Operatori Ekonomik përballon kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës për këto kosto.

#### 1.3 **Sqarim i Dokumentave të Tenderit,**

- Nëse një Ofertues kërkon cdo lloj sqarimi të Dokumentave të Tenderit duhet të kontaktoj Punëdhënësin duke i shkruajtur në adresën e tij **të specifikuar në DT**. Punonjësi do të përgjigjet me shkrim për cdo kërkesë për sqarim, që i drejtohet 10 dite para hapjes së tenderit. Punëdhënësi duhet të përcjellë kopje të përgjigjeve të tij tek të gjithë Ofertuesit që kanë blere Dokumentat e Tenderit, duke përfshirë një përrshkrim të pyetjes por pa e identifikuar burimin e saj. Nëse si pasoje e sqarimeve të mesiperme, ka ndryshime esenciale në Dokumentat e Tenderit, atëherë ato do të modifikohen nepermjet amendamenteve perkatese.

#### 1.4 **Amendamentet e Dokumentave të Tenderit**

- Në cdo kohë para afati të fundit të dorëzimit të ofertave, Punëdhënësi mund të ndryshojë Dokumentat e Tenderit duke lëshuar një ose disa shtojca (addenda), që do të gjukohen të arsyeshme gjatë fazës së sqarimeve dhe pyetjeve nga ana e operatoreve që kanë blere dokumentat e tenderit.
  - Përgjigjet e pyetjeve që do të drejtohen nga operatorët, para datës së hapjes së tenderit, do të konsultohen me Bankën Botërore, së bashku me amendamentin perkates (nëse do të ketë).
  - Cdo sqarim dhe shtojcë e lëshuar duhet të jetë pjesë e Dokumentave të Tenderit dhe duhet t'u komunikohet me shkrim të gjithë operatoreve që kanë blerë Dokumentat e Tenderit nga Punëdhënësi, pa identifikuar burimin se cili operator ka kërkuar sqarim. Punëdhënësi do të publikojë me përpikmëri shtojcën/ ose amendamentin në faqen e web-it të Entit Prokurues.
- 1.5 Për t'ju dhënë Ofertuesve të pritshëm kohë të arsyeshme për të marrë në konsideratë, gjatë përgatitjes të ofertave të tyre, amendamentin (shtojcën), Punëdhënësi mund, në gjykimin e tij, të zgjasi afatin e fundit të marrjes dhe hapjes të ofertave.

1.6 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç

literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me iniciale ose të nënshkruhen nga Personi(-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar.



1.7 Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomikë, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së prokurimit.

1.8 **Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**

- a) Formularin e Ofertës (Preventivi), plotësuar sipas Shtojcës 1.
- b) Sigurimin e Ofertes, plotësuar sipas Shtojcës 3
- c) Preventivi me kosto
- d) Forma e Kualifikimit të ofertuesve dhe dokumentat mbështetës (Shtojca 7)
- e) Dokumentat dhe vërtetimet e kërkuara në Shtojcën 4, 5, 6, 9 dhe 11.
- f) Marreveshja e "Joint Venture", në rast se operatori ekonomik është bashkim operatorësh
- f) Ose ndonjë kërkesë/ dokument tjetër i vecantë i kërkuar në dokumentat e tenderit.

Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

Ndermarrjet dhe Institucionet Qeveritare mund të marrin pjesë në tender nëse ato vërtetojnë se:

- a) Janë ligjerisht dhe financiarisht të pavarur nga qeveria
- b) Veprojnë sipas ligjeve tregëtare të Republikës së Shqipërisë
- c) Nuk janë Institucione apo agjensi varesie të Fondit Shqiptar të Zhvillimit

1.9 Përveç kërkesave në paragrafin 1.8, ofertat e paraqitura nga JV do të përfshijnë një kopje të Marrëveshjes të Sipërmarrjes së Përbashkët të firmosur nga të gjithë anëtarët. Ofertuesit që kuotojnë si JV do të jenë përgjegjës në mënyrë individuale dhe të përbashkët për zbatimin e kontratës. Për këtë, në Marrëveshjen e JV (bashkëpunimit), operatorët ekonomik duhet të cilesojnë se **“Për ekzekutimin e kësaj kontrate për të cilën po kuotojnë, mbajnë përgjegjësi individuale dhe të përbashkët njëkohësisht”**.

Në rast se Ofertuesi është një JV, Oferta do të firmoset ose nga të gjithë anëtarët e JV ose nga një përfaqësues i autorizuar nga JV. Në këtë rast, përveç marrëveshjes së përbashkët të JV, ofertuesi duhet të paraqesë dhe një prokurë të nënshkruar nga përfaqësuesit e tyre ligjorë, që autorizojnë një përfaqësues të përbashkët për nënshkrimin e ofertes në emër të JV.

1.10 Ofertuesit e huaj nuk do të përjashtohen nga pjesëmarrja dhe ofertuesve vendas nuk do të jipet asnjë preferencë gjatë procesit të tenderimit. Nëse dokumentat e tenderit do të shiten, vetëm operatorët që blejnë zyrtarisht dokumentat e

tenderit, do të regjistrohen si pjesëmarrës në tender, dhe do të prezantojnë ofertën e tyre.

1.11 Fshehtësia e procesit sipas nenit 25 të LPP-së.

1.12 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë vetëm ofertën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: “Ofertë për ekzekutimin e punëve; Nr. e Njoftimit.

**“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA dd/mm/vv \_\_\_\_\_ orës \_\_\_\_\_”.**

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).**

- 1.13 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin ofertat e tyre, me kusht që ky modifikim ose tërheqje të kryhet para afatit kohor përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet, ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim para datës së fundit për dorëzimin e ofertave. Zarfë që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet përkatësisht: **“MODIFIKIM OFERTE”** ose **“TËRHEQJE OFERTE”**.

#### **Afati Përfundimtar i dorëzimit të ofertave**

- 1.14 Te gjitha ofertat duhet të dorëzohen brenda afatit të përcaktuar (date dhe kohe) në dokumentat e tenderit. Cdo ofertues do të dorëzojë vetëm një ofertë, ose individualisht ose si partner i një bashkimi operatorësh (JV). Një ofertues i cili paraqet ose merr pjesë në më shumë se një ofertë (ai ka të drejtë të marrë pjesë vetëm si nenkontraktor ose nëse ofertat alternative lejohen) atëherë të gjitha propozimet e ardhura nga pjesëmarrja e këtij ofertuesi do të skualifikohen.

#### **Ofertat e Vonuara**

- 1.15 Ofertat e Vonuara. Punëdhënësi nuk do të marrë në konsideratë asnjë ofertë që vjen pas afatit të përfundimit të dorëzimit të ofertave. Cdo ofertë e marrë nga Punëdhënësi pas afatit të përfundimit të dorëzimit të ofertave do të deklarohet e vonuar, refuzuar dhe do të rikthehet e pahapur të Ofertuesit.

#### **Hapja e Ofertave**

- 1.16 Punëdhënësi do të hapë dhe lexojë publikisht të gjitha ofertat e ardhura brenda afatit, në datën, kohën dhe vëndin e **specifikuar në DT**, në prezencë të përfaqësuesve të caktuar të Ofertuesve dhe cdokush që vendos të marrë pjesë.
- 1.17 Gjithë zarfet do të hapen me rradhë e do të lexohen: emri i Ofertuesit dhe nëse ka modifikime; Cmimi total i Ofertës, për lot(kontratë) nëse është e aplikueshme, duke përfshirë cdo ulje dhe oferta alternative (nese lejohen); prezenca ose mungesa e një sigurimi oferte, dhe cdo detaj tjetër që Punëdhënësi e mendon të nevojshëm. Vetëm uljet dhe ofertat alternative të lexuara në hapjen e ofertave do të merren në konsideratë për vlerësim. Formulari i Ofertës dhe Lista e cmimeve/ Preventivi do të jenë të sigluara faqe me faqe nga përfaqësuesit e Punëdhënësit (komisioni i vlerësimit) që marrin pjesë në hapjen e ofertave. Punëdhënësi nuk duhet t'i diskutojë cilësitë e ndonjë oferte apo të refuzojë ndonjë ofertë gjatë procesit të hapjes së

ofertave. Vetem ofertat qe vijne me vonese do te refuzohen qe te hapen dhe do ti kthehen ofertuesit te pahapura.

- 1.18 Punëdhënësi do të përgatise një proces-verbal per hapjen e ofertave që do të përfshijë, minimalisht: emrin e Ofertuesit dhe nëse ka një tërheqje, zëvendësim, apo modifikim; Çmimin e Ofertës, për lot(kontratë)nëse aplikohet, duke përfshirë cdo ulje ose ofertë alternative; dhe prezencën ose mungesën e sigurimit të ofertës, nëse është kërkuar një i tillë. Përfaqësuesit e Ofertuesve që janë prezent do t'u kërkohe të firmosin proces verbalin. Lënia jashtë e firmës të një Ofertuesi në proces verbal nuk do të bëj të pavlefshëm përmbajtjet dhe efektet e proces verbalit. Nderkohe qe komisioni i vleresimit duhet te firmose proces-verbalin pa asnje perjashtim. Një kopje e proces verbalit do t'u shpërndahet të gjithë Ofertuesve.

## **Seksioni 2 Përlllogaritja e ofertës ekonomike**

- 2.1 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës, sipas standartit te bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar punët që do të realizohen, sasi të dhe çmimin e tyre per “kontratat me çelsa në dore” dhe “çmimet fikse” për kontratat e punimeve me matje.
- 2.2 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.
- 2.3 Ofertuesi duhet të shënojë në preventiv çmimet për cdo zë punimi dhe çmimin total të ofertës të të gjitha punëve, pa TVSH. Vlera e TVSH-se, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.
- 2.4 Vetem ne rastet kur Dokumentat e Tenderit e parashikojnë ndryshe, çmimet e dhëna nga Ofertuesi duhet të jenë të fiksuar përgjatë ekzekutimit të kontratës dhe nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë ndryshimi në asnjë aspekt. Oferta e paraqitur me çmim të ndryshueshëm dhe që nuk është në përputhje me këtë paragraf, do të refuzohet nga Autoriteti Kontraktor si e papranueshme.
- 2.5 Ne rast se operatoret ekonomik paraqesin oferta me cmime me te larta se vlera e perlllogaritur me pare (buxheti), keto oferta nuk do te skualifikohen pa u konsultuar me pare me Banken Boterore.
- 2.6 Sigurimi i Ofertës kur kërkohe duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës do të ketë si pasojë refuzimin e ofertës.
- 2.7 Sigurimi i Ofertës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
  - b) garanci/police sigurimi

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet të dorëzohet si format original bashkë me ofertën para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

Garancia e Ofertes dhe e Kontrates do të jete sipas formateve respektive të perfshire ne kete dokument tenderi. Garancia e Ofertes do të jete e vlefshme 28 dite (njezet e tete dite), pas periudhes se vlefshmerise origjinale te ofertes, ose pertej kesaj periudhe ne rast se kerkohet ndonje zgjatje periudhe vlefshemrie oferte. Në rastin kur sigurimi i ofertës ka formën e një garancie bankare, Autoriteti Kontraktor ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Nuk do të ekzekutohet asnjë pagesë në avance për kontraktorin, nëse nga ana e tij nuk do të leshohet një garanci Bankare me të njëjten vlerë dhe në formatin e kërkuar sipas dokumentave të tenderit.

i. Sigurimi i ofertes mund të konfiskohet:

(a) Nëse një Ofertues tërheq ofertën e tij gjatë periudhës së vlefshmerisë së ofertes, që është e specifikuar në Formularin e Ofertes, ose të ndonjë zgjatje vlefshmerie të

kërkuar dhe të pranuar nga ofertuesi.

(b) Nëse ofertuesi i suksesshëm refuzon/ deshton të:

1. Nënshkruajë Kontraten

2. Të dorëzojë Garancinë e Kontrates.

ii. Garancia e ofertes duhet të leshohet në emër të JV (bashkimit të operatoreve) paraqesin ofertën, në rast të kundërt ajo është arsye kryesore për skualifikimin e ofertuesit.

## **2.8 Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës.**

Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Për sa kohë nuk ka skaduar afati kohor për vlefshmërinë e ofertave, Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund t'a refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim, dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti Kontraktor do të refuzojë ofertën.

Ofertat do të mbeten të vlefshme për një periudhë 90 ditë pas paraqitjes të datës të afatit përfundimtar të ofertës. Vlefshmëria e ofertës për një periudhë më të shkurtër do të refuzohet nga Punëdhënësi si papërgjegjeshme.

Në situata të përjashtuara, para mbarimit të periudhës së vlefshmërisë të ofertës, Punëdhënësi mund t'ju kërkojë Ofertuesve të shtyjnë periudhën e vlefshmërisë të

ofertave të tyre. Kërkesat dhe përgjigjet do të jenë të shkruara. Me te njejtin afat do te kerkohet te shtyhet gjithashtu edhe garancia e ofertes. Një Ofertues mund të refuzojë kete kërkesë pa humbur sigurimin e ofertës së tij. Ofertuesi duke pranuar kërkesën nuk do të pyetet ose lejohet të modifikojë ofertën e tij.

## 2.9 Gjykuesi

Punedhenesi propozon ne kete dokument tenderi, Z.Ervin Karaj, te emeruar si Gjykues per kontraten, me pagese orare te specifikuar ne kontrate plus shpenzimet e rimbursueshme. Nese Ofertuesi nuk eshte dakort me kete propozim, ai duhet ta percaktoje mos-dakortesine e tij ne oferte.

Nese ne Letren e Pranimit, Punedhenesi nuk eshte dakort me Gjykuesin e emeruar, atehere ai do ti drejtohet Autoritetit/ Institucionit Emerues te percaktuar ne kontrate, klauzola , per te emeruar nje Gjykues tjeter.

Pagesa për orë dhe llojet e shpenzimeve të rimbursueshme që i paguhen “Gjykues teknik/ inxhinier civil”: **3,000 leke/ore**

**CV personale e Gjyksesit eshte si me poshte:**

## CURRICULUM VITAE

**Mbiemri:** KARAJ  
**Emri:** Ervin  
**Ditëlindja:** 10 NENTOR 1974  
**Kombësia:** Shqiptar  
**Mob:** +355 67 20 65 064  
**E-mail:** ervin.karaj@ice.al

### Edukimi:

Institucioni (Nga data - Deri në datën)	Grada(t) ose Diploma(t) e marra:
Universiteti Politeknik i Tiranës , Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit 1993 – 1998	Diplomë në Inxhinieri Ndërtimi, Profili Civile - Industriale

**Gjuhët e Huaja:** Treguesi i aftësisë në shkallën 1 deri në 5 (1 - shkëlqyeshëm; 5 – njohuri bazë)

Gjuha	Lexim	E folur	E shkruar
Anglisht	1	2	2
Italisht	2	3	3

**Aftësi të Tjera:** (p.sh. Njohuri kompjuterike, etj.)

- Njohuri mbi programet SAP2000, ETABS, AutoCAD, Microsoft Office, etc.
- Njohuri të mira mbi FIDIC.
- Aftësi të mira komunikuese.

### Pozicioni i Tanishëm:

- Drejtues i grupit të Supervizionit në terren për ndërtime civile, supervizor për Rrugë, Infrastrukturë, Struktura dhe Vepra Arti, etj.

**Kualifikime Bazë:** (të lidhura me pozicionin e kërkuar):

- Drejtues i grupit të Supervizionit në terren për objektin “Ndërtim i Xhamisë së Namazgjasë, Tiranë”.
- Supervizor në projektin e Rikonstruksionit të Rrugëve Rurale dhe Sekondare.
- Aftësi të mira në kordinimin e aktorëve dhe aktiviteve të ndryshëm për projekte shumëdisiplinore.
- Drejtues i një grupi prej 7 inxhinierësh dhe arkitektësh.

## Eksperienca Profesionale

Nga data Në datën	Vendndodhja	Kompania (emri dhe detaje kontakti)	Pozicioni	Përshkrimi
05/2015 deri në Aktualisht	Tiranë, Shqipëri	ICE Sh.p.k ice@ice.al	Drejtues i grupit të Supervizionit në terren	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Ndërtim i Xhamisë së Namazgjasë, Tiranë.</b></li> </ul> <p>Projekti konsiston në ndërtimin në një sipërfaqe prej 10000 metrash katrorë, në vendin e njohur si Namazgjaja e Tiranës, të xhamisë së re, me kupolën e lartë 36 metra dhe katër minaret, lartësia e të cilave shkon në 56 metra. Xhamia e re do të jetë një kompleks multifunksional, që do ta shndërrojë Namazgjanë në një zonë sociale për të gjithë banorët e kryeqytetit. Objekti parashikohet të ndërtohet brenda tri viteve dhe kërkon shumën e rreth 30 milionë eurove.</p> <p>Projekti përfshin ndër të tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pilota me shpim për gjatë gjithë perimetrit të sipërfaqes së ndërtimit me lartësi variabël deri në 13.2 m</li> <li>• Punimet për injektimin e ankerave me thellësi 14, 17 dhe 19.6 me tre nivele ankerimi</li> <li>• Ndërtimin e themelit tip pllakë solide beton arme</li> <li>• Ndërtimin e konstruksionit prej betoni të armuar të përbërë nga kollonat, muret, qemerët, trarët, soletat,</li> </ul>



Nga data Në datën	Vendndodhja	Kompania (emri dhe detaje kontakti)	Pozicioni	Përshkrimi
				<p>kupolat, 4 minaret me lartësi 56 m etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Punimet e rifiniturës ( muraturë, suvatime, veshje me pllaka guri, mermeri, lyerje, kaligrafitë etj.).</li> <li>• Punimet e instalimeve elektrike dhe mekanike.</li> </ul> <p><i>Veprimtaria e kryer:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtues i grupit të Supervizionit në terren.</li> <li>- Zv/Projekt Manaxher i grupit të supervizionit i përbërë nga inxhinieri topograf, inxhinieri gjeoteknik, inxhinieri i materialeve, inxhinieri mekanik, inxhinieri elektrik, arkitekti.</li> </ul>
03/2013 deri në 05/2015	Tiranë, Shqipëri	IRD Engineering Znj. Giulia D'agostini g.dagostini@irdeng.com	Inxhinier i mbikqyrjes së projektit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Mbikqyrja e Punëve për Rehabilitimin e Rrugëve Rurale dhe Dytësore të Shqipërisë..</b></li> </ul> <p>Objektivi kryesor i Supervizionit ka qenë mbikëqyrja e punëve të kontraktuara civile duke përfshirë monitorimin, inspektimin dhe raportimin e aktiviteteve mbikëqyrëse. Projekti ka të bëjë me rehabilitimin dhe rindërtimin e 1500 km rrugë (lokale ose dytësore) në të gjithë Shqipërinë.</p> <p>Veprimtaria e kryer:</p> <p>Inxhinierit në kantier i Supervizionit për periudhën ndërmjet 01 Mars 2013 dhe</p>

Nga data Në datën	Vendndodhja	Kompania (emri dhe detaje kontakti)	Pozicioni	Përshkrimi
				<p>31 Marsit 2015, për rehabilitimin e rrugëve lokale në Elbasan, Fier dhe Qarkun e Beratit të përbëra nga një total prej 51km ndarë në 4 Kontratat me një çmim të kombinuar prej 21 milion euro të kontratës të financuar nga BERZH.</p>
<p>11/2008 deri në 03/2013</p>	<p>Tiranë, Shqipëri</p>	<p>Louis Berger SAS robertobaroncin@yahoo.it.</p>	<p>Inxhinier i mbikqyrjes së projektit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Mbikqyrja e Punëve për Rehabilitimin e Rrugëve Rurale dhe Dytësore të Shqipërisë.</b></li> </ul> <p>Objektivi kryesor i Supervizionit ka qenë mbikqyrja e punëve të kontraktuara civile duke përfshirë monitorimin, inspektimin dhe raportimin e aktiviteteve mbikqyrëse. Projekti ka të bëjë me rehabilitimin dhe rindërtimin e 1500 km rrugë (lokale ose dytësore) në të gjithë Shqipërinë.</p> <p>Veprimtaria e kryer:</p> <p>Inxhinierit në kantier i Supervizionit për periudhën ndërmjet 28 Nëntor 2008 dhe 01 Marsit 2013, në rehabilitimin e rrugëve lokale në qarqet Kukës, Has, Peshkopi, Tropoja dhe Lushnje, të përbëra nga një total prej 120 km ndarë në 12 Kontrata dhe vlerë 50 M Euro financuar nga Banka Botërore, BERZH, CEB, OFID.</p>
<p>09/2004 deri 11/2008</p>	<p>Tiranë, Shqipëri</p>	<p>Spartaku sh.p.k. spartaku94tr@yahoo.com  Illir Mustafaj 0682041915</p>	<p>Inxhinier zbatimi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Inxhinier i zbatimit në projektet e mëposhtme të financuara nga D.P.Rr dhe ADF:</b></li> </ul>

Nga data Në datën	Vendndodhja	Kompania (emri dhe detaje kontakti)	Pozicioni	Përshkrimi
				<p>"Rikonstruksioni i rrugës Borsh – Sarandë, Loti i I-rë"                      "Rindërtimi i rrugës urbane"                      Ramiz Aranitasi "Fier"                      "Rikonstruksioni i rrugës Belsh- Gradisht"                      "Stabilizimi i rrëshqitjes në rrugën nacionale Patos"                      "Mirëmbajtja e rrugës Zall Bastar"</p> <p><i>Veprimtaria e kryer:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Prodhimi i materialeve të fraksionuara për shtresat rrugore dhe trotuaret</li> <li>- Realizimi i shtresave rrugore, punime të dherave, shtresa asfaltike, montimin e strukturave të betonit si tombino, mure mbajtës, kontrolli i cilësisë, përgatitja e çertifikatave të pagesës, përgatitja e urdhrave për ndryshim të projektit, etj</li> <li>- Zbatimi i procedurave të kantierit dhe menaxhimi i kontratës.</li> <li>- Mbajtja e ditarit të punimeve</li> <li>- Kontrolli i sasive të realizuara në baza ditore</li> <li>- Asistencë në marrjen e mostrave dhe testimin e aktiviteteve</li> </ul>
06/2003 deri në 08/2004	Tiranë, Shqipëri	ALBAVIA	Inxhinier zbatimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Inxhinier i zbatimit në projektin e</b></li> </ul>

Nga data Në datën	Vendndodhja	Kompania (emri dhe detaje kontakti)	Pozicioni	Përshkrimi
		Lorenc Mishaxhiu 0692052800		<p><b>mëposhtëm të financuar nga D.P.Rr.</b></p> <p>“Ndërtimi i rrugës Zall Herr”, të përbërë nga ndërtimi i 3 km rrugë, me gjerësi 5m + 2 x 1 trotuare. Projekti përfshinte ndërtimin e shtresave rrugore, shtresa të reja asfalti, tombino, muret e betonit, ndriçimin rrugor, linjë e ujës-jellësit, rrjetit të kanalizimit.</p> <p><i>Veprimtaria e kryer:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Prodhimi i materialeve të fraksionuara për shtresat rrugore dhe trotuaret</li> <li>- Realizimi i shtresave rrugore, punime të dherave, shtresa asfaltike, montimin e strukturave të betonit si tombino, mure mbajtës, kontrolli i cilësisë, përgatitja e çertifikatave të pagesës, përgatitja e urdhrave për ndryshim të projektit, etj</li> <li>- Zbatimi i procedurave të kantierit dhe menaxhimi i kontratës.</li> <li>- Mbajtja e ditarit të punimeve</li> <li>- Kontrolli i sasive të realizuara në baza ditore</li> <li>- Asistencë në marrjen e mostrave dhe testimin e aktiviteteve</li> </ul>

Nga data Në datën	Vendndodhja	Kompania (emri dhe detaje kontakti)	Pozicioni	Përshkrimi
06/1999 deri në 05/2003	Tiranë, Shqipëri	"Karl Gega" sh.p.k.  Shkëlqim Rakipaj 0692023632	Inxhinier zbatimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Inxhinier i zbatimit në projektet e mëposhtme të financuara nga Bashkia Tiranë dhe ADF:</b></li> </ul> <p>“Rehabilitimi i rrugës urbane "Budi" “Tirane financiar nga bashkia e Tiranës. Projekti përfshinte rehabilitimin e shtresave rrugore, shtresa të reja asfaltike, ndriçimin rrugor, linjë e ujësjellësit, rrjetit të kanalizimit.</p> <p>“Rikonstruksioni i rrugëve urbane Tirane "Mihal Grameno"”, financiar nga bashkia e Tiranës. Projekti përfshinte rehabilitimin e shtresave rrugore, shtresa të reja asfaltike, ndriçimin rrugor, linjë e ujësjellësit, rrjetit të kanalizimit.</p> <p>“Rikonstruksioni i rrugëve urbane Tirane "Qemal Stafa"”, i financuar nga Bashkia e Tiranës. Projekti përfshinte rehabilitimin e shtresave rrugore, shtresa të reja asfaltike, ndriçimin rrugor, linjë e ujësjellësit, rrjetit të kanalizimit.</p> <p>“Rikonstruksioni i rrugës "Skenderbej"” Dures Projekti përfshinte rehabilitimin e shtresave rrugore, shtresa të reja asfaltike, ndriçimin rrugor, linjë e ujësjellësit, rrjetit të kanalizimit.</p> <p><i>Veprimtaria e kryer:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Prodhimi i materialeve të</li> </ul>

Nga data Në datën	Vendndodhja	Kompania (emri dhe detaje kontakti)	Pozicioni	Përshkrimi
				<p>fraksionuara për shtresat rrugore dhe trotuaret</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Realizimi i shtresave rrugore, punime të dherave, shtresa asfaltike, montimin e strukturave të betonit si tombino, mure mbajtës, kontrolli i cilësisë, përgatitja e çertifikatave të pagesës, përgatitja e urdhrave për ndryshim të projektit, etj</li> <li>- Zbatimi i procedurave të kantierit dhe menaxhimi i kontratës.</li> <li>- Mbajtja e ditarit të punimeve</li> <li>- Kontrolli i sasive të realizuara në baza ditore</li> <li>- Asistencë në marrjen e mostrave dhe testimin e aktiviteve</li> </ul>

### **Seksioni 3. Vlerësimi i Ofertave**

#### **3.1 Fshehtesia**

Informacionet që posedohen gjatë procesit të vlerësimit, do të jete teresisht koefidencial dhe nuk do të jipen detaje për askend, deri në moemntin e njoftimit të dhenies së kontrates/ njoftimit të fituesit.

#### **3.2 Procesi i sqarimit të ofertave**

Për efekt saktësimi, qartësimi apo plotësim dokumentacioni historik, që nuk modifikojnë ofertën e ofertuesit, komunikimi me ofertuesit do të bëhet vetëm nepermjet shkrimit dhe komunikimit zyrtar.

Edhe nëse ofertuesit do të desherojnë të komunikojnë me punëdhënësin, gjatë kësaj periudhe, ato mund ta bëjnë një gjë të tillë vetëm nepermjet komunikimit zyrtar me shkrim.

#### **3.3 Devijimet, Rezervime and "Heqje"**

Gjatë vlerësimit të ofertave, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

"Devijime" është një largim nga kërkesat e përcaktuara në Dokumentin e Tenderit  
"Reservation" është vendosja e kufizuar e kushteve apo fshehje nga pranimin e plotë të kërkesave të përcaktuara në Dokumentin e Tenderit; dhe  
"Heqja" është paraqitje e pjesëshme e informacionin apo dokumentacionin e kërkuar në Dokumentin e Tenderit.

#### **3.4 Korrigjimi i Gabimeve Aritmetike**

Pasi oferta vlerësohet e përgjegjeshme, punëdhënësi korrigjon gabimet aritmetikore si më poshtë.

- a) Nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është marrë duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, çmimi i njësisë do të mbizotërojë dhe çmimi i përgjithshëm duhet të korrigjohet.
- b) Nëse sipas mendimit të punëdhënësi ka një keqvendosje të dukshme të presjes dhjetore në çmimin për njësi, në këtë rast çmimi i përgjithshëm siç është i vendosur në oferte, udheheq dhe çmimi për njësi do të korrigjohet;
- c) nëse ka një gabim në një total që rezulton si pasoje e mbledhjes ose zbritjes së nëntotaleve, nëntotalet do të mbizotërojë dhe totali duhet të korrigjohet; dhe
- d) në qoftë se ka një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma në fjalë do të mbizotërojë, nëse shuma e shprehur në fjalë lidhet me një gabim aritmetik, në të cilin rast shuma në shifra do të mbizotërojë subjekt i shpjegimeve të dhëna në paragrafin (a) dhe (b) më sipër.

Ofertuesit do t'i kërkohej të pranojë korrigjimin e gabimeve aritmetike. Mos pranimit i korrigjimit të identifikuar, do të rezultojë në refuzimin e ofertës

### 3.5 Vleresimi i Ofertave

Punëdhënësi, për efekt vleresimi, do të përdorë kriteret dhe metodologjitë e listuara në këtë klauzolë. Nuk do të lelohen kritere vlerësimi apo metodologji të tjera.

- i. Për të vlerësuar një ofertë, Punëdhënësi do të marrë në konsideratë si më poshtë:
  - a) çmimin e ofertës, duke përjashtuar shumat rezerve (kontigjencen).
  - b) çmimin e ofertës, pa TVSH.
  - c) rregullimi çmimi për efekt të korigjimit të gabimeve aritmetike
  - d) rregullim të çmimeve për shkak të ulje të ofruara në oferte
  - e) rregullim të çmimeve për moskonformitetet
  - f) faktorët shtesë vlerësimi që mund të jenë përcaktuar në kushtet e veçanta të DT.

### 3.8 Krahasimi i Ofertave

Punëdhënësi do të krahasojë çmimet e vlerësuar për të gjithë ofertuesit e përgjegjshëm, në mënyrë që të përcaktojë vlerën më të ulët të ofertës.

Ofertuesi i përgjegjshëm konsiderohet ofertuesi që është i pranueshëm ligjrisht, ofron çmimin më të ulët, është i kualifikuar teknikisht dhe ofron realizimin e punimeve me cilësi dhe parametra brenda kërkesave dhe specifikimeve teknike të kërkuara nga dokumentat e tenderit.

“Çmimi i Vlerësuar” është çmimi final që rezulton nga korigjimi aritmetik, dhe rregullimet e mundshme për efekt të ekuivalencës dhe njehsimit me të gjitha ofertat e tjera (pasi janë bërë axhustimet e parashikuara në DT), dhe i zhveshur nga TVSH.

### 3.9 Kualifikimet e Ofertuesit

- 3.9.1 Të gjithë ofertuesit do të dorëzojnë formatet e plotësuara të kërkuara në **Shtojca 7.si dhe informacionet e tjera kualifikuese**, një përshkrim paraprak të metodologjisë së propozuar për realizimin e punës, grafikun e punimeve, planin e punës, përfshirë vizatimet dhe diagramat sipas nevojës.
- 3.9.2 Ofertat e dorëzuara nga një bashkim i dy ose më shumë operatorësh (JV), do të plotësojnë kushtet e mëposhtme për tu konsideruar të kualifikuar:
- 3.9.3 Ofertuesi duhet të ofrojë të gjitha informacionet e listuara në Shtojcën 7, për secilin operator të JV (bashkimit);
- 3.9.4 Oferta do të jetë e nënshkruar në mënyrë të tillë që të lidhe ligjrisht të gjithë partnerët e JV (bashkimit të operatoreve).
- 3.9.5 Të gjithë partnerët e JV do të jenë përgjegjës së bashku dhe individualisht për ekzekutimin e kontratës sipas të gjitha klauzolave të saj.
- 3.9.6 Një nga partnerët do të emërohet si lider dhe i autorizuar për të përfaqësuar JV, për të marrë instruksione dhe vepruar për dhe në emër të të gjithë partnerëve të JV; dhe Ekzekutimin e të gjithë kontratës, përfshirë pagesat, që do të behen vetëm partnerit lider (të ngarkuar).



3.9.7 Qe te kualifikohet per neneshkrim kontrate, ofertuesi duhet te plotesojne kriteret e meposhteme minimale kualifikuese:

- (a) Volumin vjetor te punimeve te ndertimit ne vleren e percaktuar ne DT (Shtojca 7);
- (b) Përvojë si kontraktues kryesor në ndërtimin e të **3 (tre)** kontrata të ngjashme në një vlerë agregate, jo më të vogël se **248,000,000** (lekë dhe që është realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit të aktivitetit të OE duke u llogaritur nga data e zhvillimit të tenderit (në përputhje me këtë kërkesë, punimet e cituara nga ofertuesi duhet të jetë të paktën 70 për qind e plotësuar).
- (c) propozimet për marrjen në kohë (te vetat, me qira, hua, etj) të pajisjeve esenciale qe kerkohen ne DT (Shtojca 7).
- (c) Te kete nje Menaxher Kontrate me te pakten vjetersine dhe eksperiencene kerkuar ne DT (Shtojca 7).
- (d) Asete te likuidueshme dhe /ose lehtësi kreditimi, ne vlere neto nga vlerat e tjera te kontraktuara, duke mos perfshire parapagimin qe mund te pretendoje te marre nga kontraktori, ne nje vlere jo me te vogel se ajo e percaktuar ne DT (Shtojca 7)
- (e) Një histori e vazhdueshme e procesit gjyqësor apo të arbitrazhit kundër ofertuesit apo ndonjë partneri të një sipërmarrje të përbashkët mund të rezultojë në mos kualifikim .

3.9.8 Shifrat për secilin nga partneret e një sipërmarrjeje të përbashkët (JV), do të mbliidhen së bashku për të përcaktuar pajtueshmërinë e ofertuesit me kriteret minimale kualifikuese 3.9.7 (a), (b) dhe (e); Megjithatë, për një ndërmarrje të përbashkët për t'u kualifikuar, të gjithë partnerët ne menyre te kombinuar duhet të përmbushin të gjitha kërkesat e kualifikimit te permendura ne paragrafin 3.9.7dhe secili prej partner individual (jo kryesor)i JV duhet të plotësojë të paktën 25% (për qind) dhe partneri kryesor duhet te plotesojte të paktën 40% e kërkesave minimale të pikes 3.9.7 (a) , ndersa për kriteret 3.9.7 (b) së paku një ortak duhet të plotësojnë kërkesat e të paktën një kontratë të natyrës, madhësisë dhe kompleksitetit të barabartë me të Punëve gjatë 5 viteve të fundit (në përputhje me këtë kërkesë, punimet e cituara duhet të jetë të paktën 70 për qind te përfunduara). Mospërmbushja e kësaj kërkesë do të rezultojë në refuzimin e ofertës së sipërmarrjes së përbashkët (JV). Përvojën dhe burimet nën-kontraktuesit 'nuk do të merren parasysh në përcaktimin pajtueshmërinë e ofertuesit me kriteret kualifikuese.

### 3.10 Përshtatshmëria e Propozimit Teknik

Vlerësimi i propozimit teknik të ofertuesit do të përfshijë, një vlerësim të kapacitetit teknik të ofertuesit për të mobilizuar pajisjeve kryesore dhe personelin për kontratën në përputhje me propozimin e saj në lidhje me metodat e punës, planifikimin, dhe pajisjet kryesore në detaje të mjaftueshme

dhe plotësisht në përputhje me kërkesat e përcaktuara seksionin “Kërkesat dhe specifikimet teknike”

- 3.10.1 Vetem ofertuesi që ofron vlerën më të ulët, që vlerësohet ligjërisht i pranueshem dhe i përgjegjshëm, teknikisht i pranueshem (që ofron specifikime teknike në përputhje me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit) dhe ofron sigurimin e ofertës në mënyrë korrekte, kalon në fazën e vlerësimit për efekt të përmbushjes së kriterëve kualifikuesë dhe teknike.
- 3.10.2 Kontrata do të jipet ofertuesit që ofron më të ulët dhe është teknikisht i përgjegjshëm referuar kriterëve të vlerësimit dhe të kualifikimit të paracaktuara në dokumentin e tenderit.
- 3.10.3 Pas procesit të tenderimit, nuk lejohet të ndermerren negociata me ofertuesin që ka ofruar më të ulët apo me ndonjë ofertues tjetër.

### **3.11 Shume Kontrata**

- 3.11.1 Ofertuesit kanë mundësi për të konkurruar për një ose më shumë lote. Ofertat do të vlerësohen duke marrë në konsideratë uljet e ofruara, nëse ka, për lote të kombinuara. Kontrata/at do t'i jipet ofertuesit ose ofertuesve që ofrojnë kosto më të ulët të vlerësuar nga punëdhënësi për lotet e kombinuara, subjekt i përmbushjes nga ofertuesi i kriterëve të kërkuara për një lot apo për kombinime lotesh, sipas rastit.
- 3.11.2 Ofertat do të vlerësohen për të gjithë artikujt nën secilin lot, dhe kontrata që do të nënshkruhet me ofertuesin e suksesshëm, do të përmbajë të gjitha artikujt nën secilin lot.
- 3.11.3 Ofertat do të vlerësohen për çdo lot individualisht. Nëse në listën e çmimeve ka artikull të pa vlerësuar me çmim, çmimi i munguar do të konsiderohet i përfshirë në çmimet e artikujve të tjerë (totalin e ofruar). Nëse një çmim nuk është përfshirë në ofertë, dhe kjo ofertë është e konsideruar e përgjegjshme, ky artikull nuk do të presupozohet të jetë i përfshirë në listën e artikujve të tjerë. Çmimi mesatar (i vlerësuar nga ofertat e tëra) i artikullit të munguar, do të shtohet në çmimin e ofertës dhe vlera totale e rivlerësuar e ofertës do të përdoret për krahasim me ofertat e tjera.
- 3.11.3 Nëse një ofertues vendos të marrë pjesë në një ose më shumë lote, ai duhet të plotësojë në mënyrë agregate kërkesat kualifikuese për lotet që ai kuoton, në mënyrë që të konsiderohet i kualifikuar dhe i përgjegjshëm.

### **3.12 E Drejta e Punëdhënësit për të Pranuar Ndonjë Ofertë, dhe të Refuzojë një ose të Gjitha Ofertat**

4.3	5.4.3	<p><b>PVC flexible corrugated pipe, fire retardant gas emitting, Heavy type, Ø 63 mm, a low of corrosive gas with accessories, complet (excavation, pipe, filling with sand, and filling, brick strip signaling).</b>  <i>Tub fleksibel PVC i brinjezuar, djegje pa flake dhe emetim gazi, tipi i rende, Ø 63mm, me te gjithë aksesoret (germim, tub, mbushja me rere, tulla, shtresa e sinjalizimit)</i></p>	ml	1,800.00		0.00
4.4	5.4.4	<p><b>PVC flexible corrugated pipe, fire retardant gas emitting, Heavy type, Ø 110 mm, a low of corrosive gas with accessories, complet (excavation, pipe, filling with sand, and filling, brick strip signaling).</b>  <i>Tub fleksibel PVC i brinjezuar, djegje pa flake dhe emetim gazi, tipi i rende, Ø 63mm, me te gjithë aksesoret (germim, tub, mbushja me rere, tulla, shtresa e sinjalizimit)</i></p>	ml	1,800.00		0.00
		<b>Sum 4 / Shuma 4</b>	<b>ALL</b>			<b>0.00</b>
		<b>TOTAL COMPONENT 5</b> TOTAL KOMPONENT 5	<b>ALL</b>			<b>0.00</b>
		<b>TOTAL SECTION 2 (Berat)</b> <i>TOTAL SEKSIONI 2 (Berat)</i>	<b>ALL</b>			<b>0.00</b>

**Shtojca 12.** [ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>8</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >

---

<sup>8</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

**Shtojca 13:**

# **Kushtet e Kontratës dhe Formatet e Kontratës**

## **Seksioni VIII. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës**

Këto Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK), të marra në konsideratë së bashku me Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK) dhe dokumente të tjera të renditura aty, duhet të përbëjnë një dokument të plotë që shpreh në mënyrë të drejtë të drejtat dhe detyrimet e të dyja palëve.

Këto Kushte të Përgjithshme të Kontratës janë hartuar bazuar në përvojën e konsiderueshme ndërkombëtare në hartimin dhe administrimin e kontratave dhe duke marrë në konsideratë prirjen në industrinë e ndërtimit për një gjuhë më të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë.

KPK-të mund të përdoren si për kontratat e vogla të bazuara në kosto për njësi dhe kontratat me shumë të përgjithshme.

## ***Përmbajtja e Kauzolave***

<b>A. Të Përgjithshme .....</b>	<b>6</b>
1. Përkufizime .....	6
2. Interpretimi .....	9
3. Gjuha dhe Legjislacioni.....	9
4. Vendimet e Menaxherit të Projektit .....	10
5. Delegimi .....	10
6. Komunikimi .....	10
7. Nënkontraktimi .....	10
8. Kontraktorët e Tjerë.....	10
9. Personeli dhe Pajisjet.....	11
10. Rreziqet e Punëdhënësit dhe Kontraktorit.....	11
11. Rreziqet e Punëdhënësit.....	11
12. Rreziqet e Kontraktorit .....	12
13. Sigurimet.....	12
14. Të Dhënat e Kantierit.....	13
15. Kontraktori Kryen Punimet.....	13
16. Punimet që Duhet të Përfundohen brenda Datës së parashikuar të Përfundimit.....	13
17. Miratimi nga Menaxheri i Projektit .....	13
18. Siguria .....	13
19. Zbulimet.....	14
20. Posedimi i Kantierit.....	14
21. Aksesi në Kantier .....	14
22. Udhëzimet, Inspektimet dhe Auditimet.....	14
23. Caktimi i Gjyksesit .....	14
24. Procedura për Mosmarrëveshjet.....	15
25. Praktikrat e Korruptuara dhe Mashtruese .....	15
<b>B. Kontrolli i Kohës .....</b>	<b>16</b>
26. Programi .....	16
27. Shtyrje e Datës së Parashikuar të Përfundimit .....	16
28. Përshpejtimi .....	17
29. Vonesat e Urdhëruara nga Menaxheri i Projektit .....	17
30. Takimet e Menaxhimit.....	17
31. Njoftimi i Hershëm.....	17
<b>C. Kontrolli i Cilësisë.....</b>	<b>18</b>
32. Evidentimi i Defekteve .....	18
33. Testimet.....	18
34. Korrigjimi i Defekteve.....	18

35. Defektet e Pakorrigjuara.....	18
<b>D. Kontrolli i Kostos .....</b>	<b>18</b>
36. Çmimi i Kontratës.....	18
37. Ndryshimet e Çmimit të Kontratës .....	19
38. Variacionet .....	19
39. Parashikimet e Xhirimit të Parasë .....	20
40. Certifikatat e Pagesës.....	20
41. Pagesat.....	20
42. Rastet e Kompensimit.....	21
43. Tatimet.....	22
44. Valutat.....	23
45. Rregullimi i Çmimit.....	23
46. Mbajtjet.....	23
47. Dëmet e Likuiduara.....	24
48. Bonusi .....	24
49. Pagesat Paradhënie.....	24
50. Garancitë .....	25
51. Ditë-Punët.....	25
52. Kosto e Riparimeve.....	25
<b>E. Përfundimi i Kontratës .....</b>	<b>26</b>
53. Përfundimi.....	26
54. Marrja në Dorëzim .....	26
55. Llogaria Përfundimtare .....	26
56. Manualet e Operimit dhe dhe Mirëmbajtjes.....	26
57. Prishja .....	27
58. Pagesa pas Prishjes së Kontratës.....	28
59. Prona	28
60. Lirimi nga Kryerja e Punimeve.....	28
61. Pezullimi i Huasë apo Kredisë Bankare .....	29



## Kushtet e Përgjithshme të Kontratës

### A. Të Përgjithshme

- 1. Përkufizime**
- 1.1 Shkrimi i trashë përdoret për identifikimin e termave të përkufizuar.
- (a) Shuma e Pranuar e Kontratës do të thotë shuma e pranuar në Shkresën e Pranimit për zbatimin dhe përfundimin e Punimeve dhe për riparimin e çdo defekti.
  - (b) Afati i Veprimtarisë është një afat kohor i veprimtarive që përfshin ndërtimin, instalimin, testimin dhe dorëzimin e Punimeve në një kontratë me shumë të përgjithshme. Këtu përfshihet një çmim me shumë të përgjithshme për secilën veprimtari, që përdoret për përcaktimin e vlerës dhe vlerësimin e efekteve të Ndryshimeve dhe Rasteve të Kompensimit.
  - (c) Gjykuesi është personi i caktuar në mënyrë të përbashkët nga Punëdhënësi dhe Kontraktori për të zgjidhur mosmarrëveshjet në shkallën e parë, sipas përcaktimeve të KPK 23.
  - (d) Bankë ka kuptimin e institucionit financiar të **emërtuar në KVK**.
  - (e) Fatura e Sasive do të thotë Fatura e plotë dhe me çmime e sasive që përbëjnë një pjesë të Ofertës.
  - (f) Rastet e Kompensimit janë atë të përcaktuara në Klauzolën e KPK-së 42 më poshtë.
  - (g) Data e Përfundimit është data e përfundimit të Punimeve pas certifikimit nga Menaxheri i Projektit, sipas Nën-Klauzolës 53.1 të KPK-ve.
  - (h) Kontrata do të thotë Kontrata midis Punëdhënësit dhe Kontraktorit për të zbatuar, përfunduar dhe mirëmbajtur punimet. Ajo përbëhet nga dokumentacioni i renditur në Nën-Klauzolën 2.3 të KPK-ve më poshtë.
  - (i) Kontraktori është pala Oferta e së cilës për të ndërmarrë Punimet është pranuar nga Punëdhënësi.
  - (j) Oferta e Kontraktorit është dokumenti i plotë i ofertës dorëzuar Punëdhënësit nga Kontraktori.

- (k) Çmimi i Kontratës është Shuma e Pranuar e Kontratës në Shkresën e Pranimit dhe më pas e rregulluar në përputhje me Kontratën.
- (l) Ditët janë ditë kalendarike; muajt janë muaj kalendarikë.
- (m) Ditë-pune janë sasia e ndryshme e punës që paguhet në bazë kohore për punëmarrësit e Kontraktorit dhe Pajisjet, përveç pagesave të lidhura me Materialet dhe Impiantin.
- (n) Një Defekt është çdo pjesë e Punimeve e papërfunduar në përputhje me Kontratën.
- (o) Certifikata e Përgjegjësisë për Defektet është certifikata e lëshuar nga Menaxheri i Projektit pas korrigjimit të defekteve të Kontraktorit.
- (p) Periudha e Përgjegjësisë për Defektet është periudha e **përcaktuar në KVK** sipas Nën-Klauzolës 34.1 dhe përllëgaritur që prej Datës së Përfundimit.
- (q) Vizatime do të thotë vizatime të Punimeve, siç përfshihen në Kontratë, si dhe vizatime të tjera shtesë dhe të modifikuara të lëshuara nga (ose në emër të) Punëdhënësi sipas Kontratës, që përfshijnë përllëgaritje dhe informacione të tjera të siguruar dhe miratuara nga Menaxheri i Projektit për zbatimin e Kontratës.
- (r) Punëdhënësi është pala që punëson Kontraktorin për të ndërmarrë Punimet, **sipas përcaktimeve në KVK**.
- (s) Pajisjet janë makineritë dhe mjetet e Kontraktorit të sjella përkohësisht në Kantier për ndërtimin e Punimeve.
- (t) “Me shkrim” ose “i/e shkruar” do të thotë e shkruar me dorë, i/e shtypur, printuar ose përpiluar elektronikisht dhe që rezulton në një dokument të përhershëm;
- (u) Çmimi Fillestar i Kontratës është Çmimi i Kontratës i përcaktuar në Shkresën e Pranimit të Punëdhënësit.
- (v) Data e Parashikuar e Përfundimit është data në të cilën parashikohet që Kontraktori të përfundojë Punimet. Data e Parashikuar e Përfundimit **përcaktohet në KVK**. Data e Parashikuar e

- Përfundimit mund të rishikohet vetëm nga Menaxheri i Projektit duke nxjerrë një urdhër për shtyrje apo përshpejtim të afatit.
- (w) Materialet janë të gjitha furnizimet, përfshirë të konsumueshmet, që përdoren nga Kontraktori në funksion të Punimeve.
  - (x) Impianti është një pjesë përbërëse e Punimeve që ka një funksion mekanik, elektrik, kimik, ose biologjik.
  - (y) Menaxheri i Projektit është personi i **emëruar në KVK-të**, (ose çdo person tjetër kompetent i caktuar nga Punëdhënësi dhe për të cilin Kontraktori ka marrë njoftim, që vepron si zëvendësues i Menaxherit të Projektit) që është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së Punimeve dhe që administron Kontratën.
  - (z) KVK do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.
  - (aa) Kantieri është zona **e përcaktuar si e tillë në KVK**.
  - (bb) Raportet e Shqyrtimit të Kantierit janë ato që u përfshinë në dokumentet e ofertës dhe janë raporte faktike dhe interpretuese mbi kushtet e sipërfaqes dhe shtresës nën sipërfaqe në Kantier.
  - (cc) Specifikim ka kuptimin e Specifikimeve të Punimeve të përfshira në Kontratë dhe të gjitha ndryshimet ose shtesat e ndërmarra ose të miratuara nga Menaxheri i Projektit.
  - (dd) Data e Fillimit **jepet në KVK**. Kjo është data më e vonë në të cilën Kontraktori nis zbatimin e Punimeve. Nuk është domosdoshmërisht në përputhje me Datat e Marrjes në Zotërim të Kantierit.
  - (ee) Një Nënkontraktor është një person ose shoqëri që ka një Kontratë me Kontraktorin për të kryer një pjesë të punës të përcaktuar në Kontratë, që përfshin punime në Kantier.
  - (ff) Punime të Përkohshme janë punimet e projektuara, ndërtuara, montuara dhe më pas të çmontuara nga Kontraktori, që nevojiten për ndërtimin dhe instalimin e Punimeve.
  - (gg) Një Variacion është një udhëzim i dhënë nga Menaxheri i Projektit që ndryshon Punimet.
  - (hh) Punimet janë ato çka Kontrata kërkon që të ndërtohet,

instalohet dhe t'i dorëzohet Punëdhënësit nga Kontraktori, **sipas përcaktimeve të KVK-së.**

- 2. Interpretimi**
- 2.1 Gjatë interpretimit të këtyre KPK-ve, fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë. Fjalët në numrin njëjës, përfshijnë gjithashtu edhe shumësin dhe fjalët në numrin shumës përfshijnë gjithashtu edhe njëjës. Krerët nuk kanë kuptim të veçantë. Fjalët kanë kuptimin e tyre të zakonshëm në gjuhën e Kontratës, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe. Menaxheri i Projektit jep udhëzime sqaruese për çështjet lidhur me këto KPK.
- 2.2 Nëse në **KVK-të përcaktohet** përfundim me seksione, referencat në KPK lidhur me Punimet, Datën e Përfundimit dhe Datën e Parashikuar të Përfundimit vlejnë për çdo Seksion të Punimeve (përveç referencave për Datën e Përfundimit dhe Datën e Parashikuar të Përfundimit për të gjithë Punimet).
- 2.3 Dokumentacioni që përbën Kontratën interpretohet sipas rendit të mëposhtëm të përparësisë:
- (a) Marrëveshje,
  - (b) Shkresë Pranimi,
  - (c) Ofertë e Kontraktorit,
  - (d) Kushtet e Veçanta të Kontratës,
  - (e) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, përfshirë Shtojcat,
  - (f) Specifikimet,
  - (g) Vizatimet,
  - (h) Fatura e Sasive,<sup>9</sup> dhe
  - (i) Çdo dokument tjetër **i renditur në KVK** si pjesë përbërëse e Kontratës.
- 3. Gjuha dhe Legjislacioni**
- 3.1 Gjuha e Kontratës dhe legjislacioni që rregullon Kontratën **përcaktohen në KVK.**
- 3.2 Përgjatë zbatimit të Kontratës, Kontraktori vepron në përputhje me kufizimet e importit të të mirave dhe shërbimeve në vendin e Punëdhënësit, kur

---

<sup>9</sup> Në kontratat me shumë të përgjithshme, fshini “Faturë Sasish” dhe zëvendësoni me “Afatet e Veprimtarive”.

(a) nga pikëpamja ligjore ose rregulloreve zyrtare, vendi i Huamarrësit ndalon marrëdhëniet tregtare me atë vend; ose

(b) përmes një akti përputhshmërie me një vendim të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Vendi i Huamarrësit ndalon të gjithë importet e të mirave nga ai vend, ose të gjitha pagesat për një vend, person, apo entitet në atë vend.

- 4. Vendimet e Menaxherit të Projektit** 4.1 Përveç rasteve kur shprehet në mënyrë specifike, Menaxheri i Projektit vendos mbi çështjet kontraktuale midis Punëdhënësit dhe Kontraktorit në rolin e tij si përfaqësues i Punëdhënësit.
- 5. Delegimi** 5.1 Nëse nuk **specifikohet ndryshe në KVK**, Menaxheri i Projektit mund të delegojë secilën prej detyrave dhe përgjegjësiive të tij tek persona të tjerë, përveç Gjukuesit, pasi të ketë njoftuar Kontraktorin, si dhe mund të anulojë çdo delegim, pasi të ketë njoftuar Kontraktorin.
- 6. Komunikimi** 6.1 Komunikimi midis palëve që përcaktohen në Kushtet është i vlefshëm vetëm kur është me shkrim. Një njoftim është i vlefshëm vetëm pasi dorëzohet.
- 7. Nënkontraktimi** 7.1 Kontraktori mund të nënkontrakttojë me miratimin e Menaxherit të Projektit, por nuk mund të lidhë një Kontratë pa miratimin me shkrim të Punëdhënësit. Nënkontraktimi nuk ndryshon detyrimet e Kontraktorit.
- 8. Kontraktorët e Tjerë** 8.1 Kontraktori bashkëpunon dhe ndan Kantierin me kontraktorë të tjerë, autoritete publike, shoqëri komunale dhe me Punëdhënësin gjatë afatit të përcaktuar në Afatet e Kontraktorëve të Tjerë, sipas **përcaktimeve në KVK**. Kontraktori siguron gjithashtu ambiente dhe shërbime për ta, sipas përshkrimit në Afat. Punëdhënësi mund të ndryshojë Afatin e Kontraktorëve të Tjerë dhe njofton Kontraktorin për këto ndryshime.

- 9. Personeli dhe Pajisjet**
- 9.1 Kontraktori punëson personelin kyç dhe përdor pajisjet e identifikuara në Ofertë për kryerjen e punimeve, si dhe personelin dhe pajisjet e tjera të miratuara nga Menaxheri i Projektit. Menaxheri i Projektit miraton çdo zëvendësim të propozuar të personelit dhe pajisjeve kyçe, vetëm nëse kualifikimet ose tiparet përkatëse janë thelbësisht të barabarta ose më të mira se atë të propozuara në Ofertë.
- 9.2 Nëse Menaxheri i Projektit i kërkon Kontraktorit të largojë një person që është pjesë e stafit apo fuqisë punëtore të Kontraktorit, duke dhënë arsyet përkatëse, Kontraktori sigurohet që personi të largohet nga Kantieri brenda shtatë ditëve dhe që ai të mos ketë më lidhje me punën në kuadrin e Kontratës.
- 9.3 Nëse Punëdhënësi, Menaxheri i Projektit ose Kontraktori përcaktojnë se një punëmarrës i Kontraktorit është përfshirë në praktika korrupsioni, mashtrimi, marrëveshesh të fshehta, ose penguese gjatë zbatimit të Punimeve, atëherë punëmarrësi largohet në përputhje me Klauzolën 9.2 më lart.
- 10. Rreziqet e Punëdhënësit dhe Kontraktorit**
- 10.1 Punëdhënësi ndërmerr rreziqet që kjo Kontratë i përcakton si rreziqe të Punëdhënësit dhe Kontraktori ndërmerr rreziqet që kjo Kontratë i përcakton si rreziqe të Kontraktorit.
- 11. Rreziqet e Punëdhënësit**
- 11.1 Që prej Datës së Fillimit deri sa të lëshohet Certifikata e Përgjegjësisë për Defektet, sa më poshtë janë rreziqet e Punëdhënësit:
- (a) Rreziku i dëmtimit të personit, vdekjes, humbjes ose dëmtimit të pronës (përveç Punimeve, Impiantit, Materialeve dhe Pajisjeve) që rrjedhin nga
- (iii) përdorimi ose zënia e Kantierit nga Punimet ose në funksion të Punimeve, që janë rezultate të pashmangshme të Punimeve, ose
- (iv) neglizhenca, shkelja e detyrave statutores, ose ndërhyrja në çdo të drejtë ligjore nga Punëdhënësi, ose një person tjetër i punësuar ose i kontraktuar nga ai, përveç Kontraktorit.
- (b) Rreziku i dëmtimit të Punimeve, Impiantit, Materialeve dhe Pajisjeve që vjen si rrjedhojë e fajit të Punëdhënësit ose për shkak të projektimit të Punëdhënësit, ose si rrjedhojë e luftës apo kontaminimit radioaktiv që

ndikon drejtpërsëdrejti vendin ku po zbatohen Punimet.

11.2 Që prej Datës së përfundimit deri kur lëshohet Certifikata e Përgjegjësisë për Defektet, rreziku i humbjes apo dëmtimit të Punimeve, Impiantit dhe Materialeve është rrezik i Punëdhënësit, përveç humbjeve ose dëmeve që vijnë si rrjedhojë e

- (a) një Defekti që kishte ndodhur përpara ose në Datën e Përfundimit,
- (b) një ngjarjeje që ndodh përpara Datës së përfundimit që në vetvete nuk ishte rrezik i Punëdhënësit, ose
- (c) veprimtarive të Kontraktorit në Kantier pas Datës së Përfundimit.

## 12. Rreziqet e Kontraktorit

12.1 Që prej Datës së Fillimit deri sa të lëshohet Certifikata e Përgjegjësisë për Defektet, rreziqet e dëmtimi të personit, vdekjes dhe humbjes, ose dëmtimit të pronës (përfshirë, por jo vetëm, Punimet, Impiantin, Materialet dhe Pajisjet), që nuk janë rreziqe të Punëdhënësit, janë rreziqe të Kontraktorit.

## 13. Sigurimet

13.1 Kontraktori bën të mundur mbulimin me sigurime, në emër të Punëdhënësit dhe të vetë Kontraktorit, që nga Data e Fillimit deri në përfundim të periudhës së Përgjegjësisë për Defekte në shumat dhe të zbritshmet e **përcaktuara në KVK** për ngjarjet e mëposhtme që vijnë si rrjedhojë e rreziqeve të Kontraktorit:

- (a) humbje e, ose dëmtim i Punimeve, Impiantit dhe Materialeve;
- (b) humbje e, ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje e, ose dëmtim i pronës (përveç Punimeve, Impiantit, Materialeve dhe pajisjeve) lidhur me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim të personit dhe vdekje.

13.2 Policat dhe certifikatat e sigurimeve i dorëzohen për miratim Menaxherit të Projektit nga Kontraktori përpara Datës së Fillimit. Të gjitha këto sigurime ofrojnë kompensim që paguhet në format dhe sasi të valutës të nevojshme për kompensimin e humbjeve ose dëmeve të shkaktuara.

13.3 Nëse Kontraktori nuk siguron këto polica dhe certifikata të kërkuara, Punëdhënësi mund të sigurojë sigurimet që duhet

- të ishin blerë nga Kontraktori dhe të kompensojë primet që Punëdhënësi ka paguar nga pagesat që në raste të tjera do t'i bëheshin Kontraktorit, ose nëse nuk ka pagesa për t'u kryer, primet konsiderohen si borxhe për t'u shlyer.
- 13.4 Ndryshimet e termave të sigurimeve nuk bëhen pa miratimin e Menaxherit të Projektit.
- 13.5 Të dyja palët zbatojnë të gjitha kushtet e policave të sigurimit.
- 14. Të Dhënat e Kantierit** 14.1 Kontraktori konsiderohet të ketë analizuar të gjitha të Dhënat e Kantierit **referuar në KVK**, përfshirë edhe të gjithë informacionin në dispozicion të Kontraktorit.
- 15. Kontraktori Kryen Punimet** 15.1 Kontraktori ndërton dhe instalon Punimet në përputhje me Specifikimet dhe Vizatimet.
- 16. Punimet që Duhet të Përfundohen brenda Datës së parashikuar të Përfundimit** 16.1 Kontraktori mund të nisë zbatimin e Punimeve në Datën e Fillimit dhe zbaton Punimet në përputhje me Programin e dorëzuar nga Kontraktori, sipas përditësimeve të miratuara nga Menaxheri i Projektit, dhe i përfundon ato brenda Datës së Parashikuar të Përfundimit.
- 17. Miratimi nga Menaxheri i Projektit** 17.1 Kontraktori i dorëzon Menaxherit të Projektit për miratim Specifikimet dhe Vizatimet që tregojnë Punimet e Përkohshme të propozuara.
- 17.2 Kontraktori është përgjegjës për projektimin e Punimeve të Përkohshme.
- 17.3 Miratimi i Menaxherit të Projektit nuk ndryshon përgjegjësinë e Kontraktorit për projektimin e Punimeve të Përkohshme.
- 17.4 Kontraktori merr miratimin e palëve të treta për projektimin e Punimeve të Përkohshme, kur është e nevojshme.
- 17.5 Të gjitha vizatimet e përgatitura nga Kontraktori për zbatimin e Punimeve të përkohshme ose të përhershme, janë objekt i miratimit paraprak nga Menaxheri i Projektit përpara se të përdoren.
- 18. Siguria** 18.1 Kontraktori është përgjegjës për sigurinë e të gjitha



veprimtarive në Kantier.

- 19. Zbulimet** 19.1 Çdo objekt me interes historik ose të një lloji tjetër ose me vlerë të konsiderueshëm që zbulohet papritur në Kantier është pronë e Punëdhënësit. Kontraktori njofton Menaxherin e Projektit për këto zbulime dhe zbaton udhëzimet e Menaxherit të Projektit për trajtimin e situatës.
- 20. Posedimi i Kantierit** 20.1 Punëdhënësi i kalon posedimin e të gjitha pjesëve të Kantierit Kontraktorit. Nëse posedimi i një pjesë nuk kalohet brenda datës së **përcaktuar në KVK**, Punëdhënësi konsiderohet të ketë vonuar fillimin e veprimtarive përkatëse dhe kjo përbën një Rast Kompensimi.
- 21. Aksesit në Kantier** 21.1 Kontraktori i lejon Menaxherit të Projektit dhe çdo personi të autorizuar nga Menaxheri i Projektit të ketë akses në Kantier dhe në çdo ambient ku po kryhen ose ku parashikohen të kryhen punime në kuadrin e Kontratës.
- 22. Udhëzimet, Inspektimet dhe Auditimet** 22.1 Kontraktori zbaton të gjitha udhëzimet e Menaxherit të Projektit që janë në përputhje me legjislacionin në fuqi të vendit ku ndodhet Kantieri.
- 22.2 Kontraktori mirëmban dhe ndërmerr të gjitha përpjekjet e arsyeshme që edhe Nënkontraktorët dhe nën-konsulentët e tij, të mirëmbajnë procesverbale dhe regjistra sistematikë të Punimeve, në formë dhe me detaje që evidentojnë qartë ndryshimet përkatëse në afate dhe kostot.
- 22.3 Kontraktori lejon dhe sigurohet që Nënkontraktorët dhe nën-konsulentët e tij të lejojnë Bankën dhe/ose personat e caktuar nga Banka të inspektojnë Kantierin dhe/ose llogaritë dhe regjistrat që lidhen me zbatimin e Kontratës dhe dorëzimin e ofertës, si dhe që këto llogari dhe regjistra të auditohen nga auditues të caktuar nga Banka, nëse Banka e kërkon një gjë të tillë. Tërhiqet vëmendja e Kontraktorit, Nënkontraktorëve dhe nën-konsulentëve të tij në Nën-Klauzolën 25.1, që ndër të tjera përcakton se veprimet që kanë si qëllim të pengojnë materialisht ushtrimin e inspektimit të Bankës dhe të drejtave të auditivit të përcaktuara në Nën-Klauzolën 22.2 përbëjnë një praktikë të ndaluar që rezulton në ndërprerje të kontratës (si dhe në përcaktimin e papranueshmërisë sipas procedurave të sanksioneve përkatëse të Bankës).
- 23. Caktimi i Gjykuesit** 23.1 Gjykuesi emërohet bashkërisht nga Punëdhënësi dhe Kontraktori në momentin e lëshimit të Shkresës së Pranimit nga Punëdhënësi. Nëse në Shkresën e Pranimit Punëdhënësi

nuk bie dakord me emërimin e Gjykuesit, Punëdhënësi i kërkon Autoritetit Emërues **të përcaktuar në KVK**, të emërojë Gjykuesin brenda 14 ditëve nga marrja e kërkesës.

23.2 Nëse Gjykuesi heq dorë ose ndërron jetë, ose nëse Punëdhënësi dhe Kontraktori bien dakord që Gjykuesi nuk po vepron në përputhje me dispozitat e Kontratës, një Gjykues i ri emërohet bashkërisht nga Punëdhënësi dhe Kontraktori. Në rast mosmarrëveshje midis Punëdhënësit dhe Kontraktorit, për një periudhë prej 30 ditësh, Gjykuesi përcaktohet nga Autoriteti Emërues **i përcaktuar në KVK**, sipas kërkesës së njëres prej palëve, brenda 14 ditësh nga marrja e kërkesës përkatëse.

#### 24. Procedura për Mosmarrëveshjet

24.1 Nëse Kontraktori beson se vendimi i marrë nga Menaxheri i Projektit është jashtë autoritetit të dhënë Menaxherit të Projektit nga Kontrata ose se vendimi është marrë në mënyrë jo të saktë, vendimi i referohet Gjykuesit brenda 14 ditësh nga njoftimi për vendimin e Menaxherit të Projektit.

24.2 Gjykuesi merr vendim me shkrim brenda 28 ditëve nga marrja e njoftimit për një mosmarrëveshje.

24.3 Gjykuesi paguhet me orë në **vlerën e përcaktuar në KVK**, së bashku me shpenzimet e rimbursueshme të llojeve **të specifikuara në KVK**, dhe kosto e pagesës ndahet barabar midis Punëdhënësit dhe Kontraktorit, pavarësisht vendimit të marrë nga Gjykuesi. Secila palë mund ta çojë vendimin e Gjykuesit në Arbitrazh brenda 28 ditëve nga marrja e vendimit me shkrim të Gjykuesit. Nëse asnjë nga palët nuk e referon vendimin në arbitrazh brenda 28 ditëve të përmendura më lart, vendimi i Gjykuesit bëhet përfundimtar dhe shtrëngues.

24.4 Arbitrazhi kryhet në përputhje me procedurat e arbitrazhit të publikuara në institucionin e përcaktuar dhe në vendin e **caktuar në KVK**.

#### 25. Praktikët e Korrupsionit dhe Mashtrueses

25.1 Banka kërkon përputhshmëri me politikën e saj lidhur me praktikën e korrupsionit dhe mashtrueses sipas përcaktimeve në Shtojcën e KPK-së.

25.2 Punëdhënësi kërkon që kontraktori të bëjë publike të gjitha komisionet ose tarifën që janë paguar ose duhet të paguhet për llogari të agentëve ose palëve të tjera në kuadër të procesit të ofertimit ose zbatimit të Kontratës. Informacioni i bërë publik duhet të përfshijë të paktën emrin dhe adresën e agentit apo palës tjetër, shumën dhe valutën, si dhe qëllimin e

komisionit, shpërblimit apo tarifës.

## B. Kontrolli i Kohës

- 26. Programi**
- 26.1 Brenda afatit të **përcaktuar në KVK**, pas datës së Shkresës së Pranimit, Kontraktori i dorëzon për miratim Menaxherit të Projektit një Program që paraqet metodat, planifikimet, rendin dhe kohën e përgjithshme për të gjitha veprimtaritë gjatë Punimeve. Në rastin e një kontrate me shumë të përgjithshme, veprimtaritë e Programit janë në përputhje me ato të Afatit të Veprimtarive.
- 26.2 Një përditësim i Programit është një program që tregon ecurinë faktike të arritur për secilën veprimtari dhe efektin e ecurisë së arritur në kohën e punës së mbetur, përfshirë të gjitha ndryshimet në lidhje me rendin e veprimtarive.
- 26.3 Kontraktori i dorëzon për miratim Menaxherit të Projektit një Program të përditësuar në intervale jo më të rralla se sa periudha e **përcaktuar në KVK**. Nëse Kontraktori nuk dorëzon një Program të përditësuar brenda kësaj periudhe, Menaxheri i Projektit mund të mos disbursojë shumën e **përcaktuar në KVK** në certifikatën e radhës të pagesës dhe mund të vijojë të mos bëjë disbursimin e shumës deri në pagesën tjetër pas datës në të cilën është dorëzuar Programi i prapambetur. Në rastin e një kontrate me shumë të përgjithshme, Kontraktori siguron një Afat Veprimtarish të përditësuar brenda 14 ditësh nga marrja e udhëzimit përkatës nga Menaxheri i Projektit.
- 26.4 Miratimi i Programit nga Menaxheri i Projektit nuk ndryshon detyrimet e Kontraktorit. Kontraktori mund të rishikojë Programin dhe t’ia dorëzojë atë Menaxherit të Projektit përsëri në çdo kohë. Një program i rishikuar paraqet efektin e Variacioneve dhe Rasteve të Kompensimit.
- 27. Shtyrje e Datës së Parashikuar të Përfundimit**
- 27.1 Menaxheri i Projektit shtyn Datën e Parashikuar të Përfundimit nëse ndodh një Rast Kompensimi, ose një Variacion që e bën të pamundur Përfundimin brenda Datës së Parashikuar të Përfundimit pa marrjen e hapave nga ana e Kontraktorit për përshpejtimin e punës së mbetur, që do t’i krijonte Kontraktori kosto shtesë.
- 27.2 Menaxheri i Projektit vendos nëse dhe sa shtyhet Data e Parashikuar e Përfundimit brenda 21 ditëve nga kërkesa drejtuar Menaxherit të Projektit nga Kontraktori për një vendim mbi efektin e një Rasti Kompensimi ose Variacioni

dhe pas dorëzimit të të gjithë informacionit mbështetës. Nëse Kontraktori nuk arrin të sigurojë njoftimin e hershëm, vonesa si rrjedhojë e këtij mos njoftimi nuk merret në konsideratë gjatë vlerësimit për Datën e re të Parashikuar të Përfundimit.

- 28. Përshpejtimi**
- 28.1 Kur Punëdhënësi dëshiron që Kontraktori të përfundojë më shpejt se Data e Parashikuar e Përfundimit, Menaxheri i Projektit merr propozimet me çmime për arritjen e përshpejtimit të nevojshëm nga Kontraktori. Nëse Punëdhënësi bie dakord me këto propozime, Data e Parashikuar e Përfundimit korrigohet përkatësisht dhe konfirmohet si nga Punëdhënësi, ashtu edhe nga Kontraktori.
- 28.2 Nëse propozimet me çmime të Kontraktorit për përshpejtimin pranohen nga Punëdhënësi, ato bëhen pjesë Çmimit të Kontratës dhe konsiderohen si Variacione.
- 29. Vonesat e Urdhëruara nga Menaxheri i Projektit**
- 29.1 Menaxheri i Projektit mund të udhëzojë Kontraktorin të vonojë fillimin ose ecurinë e çdo veprimtarie në kuadrin e Punimeve.
- 30. Takimet e Menaxhimit**
- 30.1 Menaxheri i Projektit ose Kontraktori mund të kenë nevojë që pala tjetër të marrë pjesë në takimet e menaxhimit. Punët e takimit të menaxhimit janë të rishikojë planet për punimet e mbetura dhe të trajtojë çështje të ngritura në kuadrin e procedurës së njoftimit të hershëm.
- 30.2 Menaxheri i Projektit mban procesverbal të punimeve të takimit të menaxhimit dhe u siguron kopje të procesverbalit pjesëmarrësve të takimit dhe Punëdhënësit. Përgjegjësia e palëve për veprime që do të ndërmerren vendoset nga Menaxheri i Projektit ose gjatë takimit të menaxhimit ose pas tij dhe shprehet me shkrim në adresë të të gjithë pjesëmarrësve në takim.
- 31. Njoftimi i Hershëm**
- 31.1 Kontraktori njofton Menaxherin e Projektit në momentin më të hershëm të mundshëm në lidhje me ngjarje ose rrethana të ardhshme që mund të ndikojnë negativisht cilësinë e punës, mund të rrisin Çmimin e Kontratës, ose vonojnë zbatimin e Punimeve. Menaxheri i Projektit mund të kërkojë që Kontraktori të ofrojë një vlerësim të efektit të pritshëm të ngjarjes ose rrethanave të ardhshme mbi Çmimin e Kontratës dhe Datën e Përfundimit. Vlerësimi ndërmerret nga

Kontraktori sa më shpejt të jetë e mundur.

- 31.2 Kontraktori bashkëpunon me Menaxherin e Projektit në bërjen dhe marrjen në konsideratë të propozimeve për mënyrën se si një ngjarje apo rrethanë e tillë mund të shmangët ose të reduktohet nga persona të përfshirë në punë, si dhe për zbatimin e çdo udhëzimi të Menaxherit të Projektit që vjen si rrjedhojë.

### C. Kontrolli i Cilësisë

- 32. Evidentimi i Defekteve**      32.1 Menaxheri i Projektit kontrollon punën e Kontraktorit dhe njofton Kontraktorin mbi defektet e evidentuara. Këto kontrole nuk ndikojnë përgjegjësitë e Kontraktorit. Menaxheri i Projektit mund të udhëzojë Kontraktorin të kërkojë për Defekte dhe të zbulojë e testojë të gjitha punimet ku Menaxheri i Projektit mendon se mund të ketë Defekte.
- 33. Testimet**      33.1 Nëse Menaxheri i Projektit udhëzon Kontraktorin të kryejë një testim të përcaktuar në Specifikime për të kontrolluar nëse punimet kanë Defekte dhe testimi tregon se ka të tilla, Kontraktori paguan për testimin dhe kampionët e nevojshëm. Nëse nuk ka Defekte, testimi përbën Rast Kompensimi.
- 34. Korrigjimi i Defekteve**      34.1 Menaxheri i Projektit e njofton Kontraktorin mbi çdo Defekt përpara përfundimit të Periudhës së Përgjegjësisë për Defektet, që nis pas Përfundimit, dhe është e **përcaktuar në KVK**. Periudha e Përgjegjësisë për Defektet shtyhet për sa kohë Defektet mbeten të pakorrigjuara.
- 34.2 Sa herë që jepet një njoftim për Defekt, Kontraktori korrigjon Defektin për të cilin është njoftuar brenda periudhës së kohës përcaktuar në njoftimin e Menaxherit të Projektit.
- 35. Defektet e Pakorrigjuara**      35.1 Nëse Kontraktori nuk e ka korrigjuar Defektin brenda periudhës së përcaktuar në njoftimin e Menaxherit të projektit, Menaxheri i Projektit vlerëson koston e korrigjimit të Defektit dhe Kontraktori paguan këtë vlerë.

### D. Kontrolli i Kostos

- 36. Çmimi i Kontratës**<sup>10</sup>      36.1 Fatura e Sasive përmban artikujt me çmimet përkatëse për Punimet që do të kryhen nga Kontraktori. Fatura e Sasive

---

<sup>10</sup>

Në kontratat me shumë të përgjithshme, Nën-Klauzola 36.1 e KPK-ve zëvendësohet si vijon:  
36.1 Kontraktori siguron Afate Veprimtarish të përditësuar Brenda 14 ditëve nga udhëzimi përkatës i Menaxherit të Projektit. Afati i Veprimtarive përdoret për të monitoruar dhe kontrolluar kryerjen e veprimtarive në bazë të të cilave do të paguhet Kontraktori. Nëse pagesa për materialet në kantier

përdoret për të përlogaritur Çmimin e Kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së kryer sipas tarifave të përcaktuara në Faturën e Sasive për secilin artikull.

- 37. Ndryshimet e Çmimit të Kontratës<sup>11</sup>**
- 37.1 Nëse sasia përfundimtare e punës së kryer ndryshon nga ajo në Faturën e Sasive për një artikull të caktuar me më shumë se 25 përqind, nëse ndryshimi është më i madh se 1 përqind in Çmimit Fillestar të Kontratës, Menaxheri i Projektit korrigjon tarifën për të lejuar ndryshimin. Menaxheri i Projektit nuk i korrigjon tarifat në sajë të ndryshimeve në sasi, nëse këto rezultojnë në ndryshim të Çmimit të Kontratës Fillestare me më shumë se 15 përqind, përveç se me miratim paraprak të Punëdhënësit.
- 37.2 Nëse kërkohet nga Menaxheri i Projektit, Kontraktori i siguron Menaxherit të Projektit një zbërthim të detajuar të kostos për çdo tarifë në Faturën e Sasive.
- 38. Variacionet**
- 38.1 Të gjitha Variacionet përfshihen në Programet<sup>12</sup> e përditësuara të përgatitura nga Kontraktori.
- 38.2 Kontraktori i siguron Menaxherit të Projektit një kuotim për ndërmarrjen e Variacionit kur kjo i kërkohet nga Menaxheri i Projektit. Menaxheri i Projektit vlerëson kuotim, që do të bëhet brenda shtatë (7) ditëve nga kërkesa, ose brenda një periudhe më të gjatë të përcaktuar nga Menaxheri i Projektit dhe përpara se Variacioni të urdhërohet.
- 38.3 Nëse kuotimi i Kontraktorit nuk është i arsyeshëm, Menaxheri i Projektit mund të urdhërojë Variacionin dhe të bëjë një ndryshim në Çmimin e Kontratës, që bazohet në parashikimin e vetë Menaxherit të Projektit për efektet e Variacionit mbi kostot e Kontraktorit.
- 38.4 Nëse Menaxheri i Projektit vendos se urgjenca e ndryshimit të punës do të pengonte sigurimin e një kuotimi dhe merret në konsideratë pa vonimin e punës, nuk jepet kuotim dhe Variacioni trajtohet si Rast Kompensimi.

---

do të kryhet veçmas, Kontraktori dëshmon dorëzimin e Materialeve në Kantier në mënyrë të veçantë në Afatin e Veprimtarive.

<sup>11</sup> Në kontratat me shumë të përgjithshme, zëvendësoni të tërë Klauzolën 37 me Nën-Klauzolën e re 37.1 të KPK-ve si vijon:

37.1 Afati i Veprimtarive ndryshohet nga Kontraktori për t'i bërë vend ndryshimeve të Programit ose metodës së punës të përcaktuar nga vetë Kontraktori. Çmimet në Afatin e Veprimtarive nuk ndryshohen kur Kontraktori bën këto ndryshime në Afatin e Veprimtarive.

<sup>12</sup> Në kontratat me shumë të përgjithshme, shtoni “dhe Afatet e Veprimtarive” pas “Programe.”

- 38.5 Kontraktori nuk ka të drejtën e pagesës shtesë për kostot që mund të ishin shmangur përmes njoftimit të herëshëm.
- 38.6 Në puna në Variacion i korrespondon përshkrimit të një artikulli në Faturën e Sasive dhe nëse, është opinion i Menaxherit të Projektit, se sasia e punës mbi kufirin e përcaktuar në Nën-Klauzolën 39.1 ose koha e zbatimit nuk shkaktojnë ndryshimin e kostos për njësi të artikullit, vlera e Faturës së Sasive përdoret për përlogaritjen e vlerës së Variacionit. Nëse kosto e artikullit të sasisë ndryshon, ose nëse lloji apo koha e punës së Variacionit nuk korrespondon me artikujt në Faturën e Sasive, kuotimi i Kontraktorit bëhet në formatin e vlerave të reja për artikujt përkatës së punës.<sup>13</sup>
- 39. Parashikimet e Xhirimit të Parasë**
- 39.1 Kur Programi<sup>14</sup> përditësohet, Kontraktori i siguron Menaxherit të Projektit një parashikim të përditësuar të Xhirimit të parasë. Parashikimi i xhirimit të parasë përfshin valuta të ndryshme, sipas përcaktimeve të Kontratës, të këmbjera sipas nevojës duke përdorur kursin e këmbimit në Kontratë.
- 40. Certifikatat e Pagesës**
- 40.1 Kontraktori i dorëzon Menaxherit të Projektit pasqyra mujore të vlerës së vlerësuar të punës së kryer pa shumë e përgjithshme të certifikuar më parë.
- 40.2 Menaxheri i Projektit kontrollon pasqyrën mujore të Kontraktorit dhe certifikon shumën që i duhet paguar Kontraktorit.
- 40.3 Vlera e punës së kryer përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.
- 40.4 Vlera e punës së kryer përfshin vlerën e sasive të punës në Faturën e Sasive që janë përfunduar.<sup>15</sup>
- 40.5 Vlera e punës së kryer përfshin vlerësimin e Variacioneve dhe Rasteve të Kompensimit.
- 40.6 Menaxheri i Projektit mund të përjashtoj çdo artikull të certifikuar në një certifikatë të mëparshme ose të reduktojë pjesën e çdo artikulli të certifikuar më parë në çdo certifikatë pas marrjes së informacionit përkatës.
- 41. Pagesat**
- 41.1 Pagesat rregullohen për zbritjet për pagesa paradhënie dhe mbajtjet. Punëdhënësi i paguan Kontraktorit shumat e

---

<sup>13</sup> Në kontratat me shumë të përgjithshme, fshini këtë paragraf.

<sup>14</sup> Në kontratat me shumë të përgjithshme, shtoni “ose Afat Veprimtarish” pas “Program.”

<sup>15</sup> Në kontratat me shumë të përgjithshme, zëvendësoni këtë paragraf me sa vijon: “Vlera e punimeve të kryera përfshin vlerën e veprimtarive të përfunduara në Afatin e Veprimtarive”.



certifikuara nga Menaxheri i Projektit brenda 28 ditëve nga data e lëshimit të certifikatës. Nëse Punëdhënësi kryen pagesën me vonesë, Kontraktorit i paguhet interes mbi pagesën e vonuar, kur bëhet pagesa e ardhshme. Interesi përlllogaritet nga data në të cilën duhet të ishte bërë pagesa deri në datën në të cilën bëhet pagesa e vonuar me normën mbizotëruese të interesit për kredimarrjen tregtare për secilën nga valutat në të cilën bëhen pagesat.

- 41.2 Nëse vlera e certifikuar rritet në një certifikatë të mëvonshme ose si rrjedhojë e një gjykimi nga Gjykuesi ose një Ndërmjetësi Arbitrazhi, Kontraktorit i paguhet interes mbi pagesën e vonuar sipas përcaktimeve të kësaj Klauzole. Interesi përlllogaritet nga data në të cilën do të ishte certifikuar vlera e rritur në mungesë të mosmarrëveshjes.
- 41.3 Nëse nuk përcaktohet ndryshe, të gjitha pagesat dhe zbritjet paguhen ose ngarkohen në valutat që përbëjnë Çmimin e Kontratës.
- 41.4 Artikujt e Punimeve për të cilët nuk është caktuar tarifë apo çmim nuk paguhen nga Punëdhënësi dhe konsiderohen të mbuluara nga tarifa dhe çmime të tjera në Kontratë.

## **42. Rastet e Kompensimit**

- 42.1 Sa më poshtë përbëjnë Rast Kompensimi:
- (a) Punëdhënësi nuk jep akses në një pjesë të Kantierit brenda Datës së Marrjes në Dorëzim të Kantierit, sipas Nën-Klauzolës 20.1 të KPK.
  - (b) Punëdhënësi ndryshon Afatet e Kontraktorëve të Tjerë në mënyrë të tillë që ndikohet puna e Kontraktorit sipas Kontratës.
  - (c) Menaxheri i Projektit urdhëron një vonesë ose në lëshon Vizatime, Specifikime, ose udhëzime të nevojshme për kryerjen në kohë të Punimeve.
  - (d) Menaxheri i Projektit udhëzon Kontraktorin të zbulojë ose të ndërmarrë testime shtesë të punimeve, që më pas rezultojnë të mos ketë Defekte.
  - (e) Menaxheri i Projektit në mënyrë të paarsyeshme nuk miraton lidhjen e një nënkontraktimi.
  - (f) Kushtet në terren janë konsiderueshëm më të vështira nga sa mund të arsyetohej, përpara lëshimit të Shkresës së Pranimit, nga informacioni i siguruar për ofertuesit (përfshirë Raportet e Hulumtimit të Kantierit), nga



informacione të mundësuar publikisht dhe nga inspektimi pamor i Kantierit.

- (g) Menaxheri i Projektit jep udhëzime për trajtimin e një situate të paparashikuar, të shkaktuar nga Punëdhënësi, ose kërkohet punë shtesë për siguri ose arsye të tjera.
- (h) Kontraktorë të tjerë, autoritete publike, shërbime komunale, ose Punëdhënësi nuk punojnë brenda afateve kohore dhe kufizimeve të tjera të përcaktuara në Kontratë, dhe ato shkaktajnë vonesa dhe kosto shtesë për Kontraktorin.
- (i) Vonohet pagesa paraprake.
- (j) Efektet mbi Kontraktorin të çdo Rreziku të Punëdhënësit.
- (k) Menaxheri i Projektit vonon pa arsye lëshimin e Certifikatës së Përfundimit.

42.2 Nëse një Rast Kompensimi shkakton kosto shtesë ose do të parandalonte përfundimin e punës përpara Datës së Parashikuar të Përfundimit, Çmimi i Kontratës rritet dhe/ose Data e Parashikuar e Përfundimit shtyhet. Menaxheri i Projektit vendos nëse dhe me sa rritet Çmimi i Kontratës dhe nëse dhe me sa shtyhet Data e Parashikuar e Përfundimit.

42.3 Sapo informacioni që dëshmon efektin e secilit Rast Kompensimi mbi koston e parashikuar të Kontraktorit të jetë siguruar nga Kontraktori, ai vlerësohet nga Menaxheri i Projektit dhe Çmimi i Kontratës korrigjohet përkatësisht. Nëse parashikimi i Kontraktorit konsiderohet i paarsyeshëm, Menaxheri i Projektit korrigjon Çmimin e Kontratës bazuar në parashikimin e vet. Menaxheri i Projektit presupozon se Kontraktori reagon në mënyrë kompetente dhe menjëhershme ndaj rastit.

42.4 Kontraktori nuk ka të drejtë kompensimi nëse interesat e Punëdhënësit ndikohen negativisht nga mos njoftimi i hershëm ose mos bashkëpunimi i Kontraktorit me Menaxherin e Projektit.

#### **43. Tatimet**

43.1 Menaxheri i Projektit rregullon Çmimin e Kontratës nëse tatimet, detyrimet, dhe taksa të tjera ndryshojnë midis datës 28 ditë përpara dorëzimit të ofertave për Kontratën dhe datës së certifikatës së fundit të Përfundimit. Rregullimi është ndryshimi midis tatimeve të pagueshme nga Kontraktori, nëse këto ndryshime nuk janë pasqyruar në

Çmimin e Kontratës ose vijnë si rrjedhojë e Klauzolës 44 të KPK-ve.

**44. Valutat** 44.1 Në ato raste kur pagesat bëhen në valuta të tjera përveç asaj të vendit të Punëdhënësit të **përcaktuar në KVK**, kursi i këmbimit i përdorur për përlogaritjen e shumave për t'u paguar është kursi i këmbimit i përcaktuar në Ofertën e Kontraktorit.

**45. Rregullimi i Çmimit** 45.1 Çmimet rregullohen për luhatjet në koston e përbërësve vetëm nëse **përcaktohet në KVK**. Nëse bëhet ky përcaktim, shumat e certifikuara në secilën certifikatë pagese, përpara zbritjes së Pagesës Paraprake, rregullohet duke aplikuar faktorin përkatës të rregullimit të çmimit për shumat e pagesave për t'u kryer në çdo valutë. Për çdo valutë të Kontratës aplikohet një formulë e veçantë e përcaktuar më poshtë:

$$P_c = A_c + B_c \text{ Imc/Ioc}$$

ku:

$P_c$  është faktori i rregullimit për pjesën e Çmimit të Kontratës që paguhet në një valutë të veçantë "c."

$A_c$  dhe  $B_c$  janë koeficientët<sup>16</sup> e **përcaktuar në KVK**, që përfaqësojnë pjesët jo të rregullueshme dhe të rregullueshme përkatësisht, të Çmimit të Kontratës të pagueshëm në atë valutë "c" të veçantë; dhe

$\text{Imc}$  është indeksi mbizotërues në fund të muajit që po faturohet dhe  $\text{Ioc}$  është indeksi mbizotërues 28 ditë përpara hapjes së Ofertimit për përbërësit e pagueshëm; që të dyja në valutën "c" të veçantë.

45.2 Nëse vlera e indeksit ndryshohet pasi të jetë përdorur për një llogaritje, llogaritja korrigjohet dhe bëhet një rregullim në certifikatën e ardhshme të pagesës. Vlera e indeksit konsiderohet të marrë parasysh të gjitha ndryshimet në kosto që rrjedhin nga luhatjet në kosto.

**46. Mbajtjet** 46.1 Punëdhënësi mban nga secila pagesë që i detyrohet Kontraktorit pjesën e **përcaktuar në KVK** deri në Përfundim

<sup>16</sup> Shuma e dy koeficienteve  $A_c$  dhe  $B_c$  duhet të jetë 1 (një) në formulën për çdo valutë. Normalisht, të dy koeficientët do të jenë të njëjtë në formulat për të gjitha valutat, duke qenë se koeficienti  $A_c$ , për pjesën e parregullueshme të pagesave, është një shifër shumë e përafërt (zakonisht 0.15) për të marrë parasysh elementet e kosto fikse ose përbërës të tjerë të parregullueshëm. Shuma e rregullimeve për secilën valutë mblidhet me Çmimin e Kontratës.

të të gjitha Punimeve.

46.2 Pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit të Punimeve nga Menaxheri i Projektit në përputhje me Nën-Klauzolën 51.1 të KPK-ve, gjysma e shumës së mbajtur i paguhet Kontraktorit dhe gjysma tjetër i paguhet pas kalimit të Periudhës së Përgjegjësisë për Defektet dhe Menaxheri i Projektit ka certifikuar që të gjitha Defektet e njoftuara Kontraktorit nga Menaxheri i Projektit përpara përfundimit të periudhës janë korrigjuar. Kontraktori mund të zëvendësojë paratë e mbajtjes me një garanci Bankare “sipas kërkesës”.

#### 47. Dëmet e Likuiduara

47.1 Kontraktori i paguan dëmet e likuiduara Punëdhënësit në normën ditore të **përcaktuar në KVK** për secilën ditë që Data e Përfundimit shtyhet në krahasim me Datën e Parashikuar të Përfundimit. Shuma e përgjithshme e dëmeve të likuiduara nuk kalon shumën e **përcaktuar në KVK**. Punëdhënësi mund të zbrisë dëmet e likuiduara nga pagesat për Kontraktorin. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk ndikon në përgjegjësitë e Kontraktorit.

47.2 Nëse Data e Parashikuar e Përfundimit shtyhet pas pagesës së dëmeve të likuiduara, Menaxheri i Projektit korrigjon mbi pagesat në certifikatën vijuese të pagesës. Kontraktori paguan interes mbi pagesën, llogaritur nga data e pagesës deri në datën e shlyerjes me normat e përcaktuara në Nën-Klauzolën 41.1 të KPK-ve.

#### 48. Bonusi

48.1 Kontraktorit i paguhet një Bonus i llogaritur me normën për ditë kalendarike të **përcaktuar në KVK** për secilën ditë (duke zbritur ditët për të cilat Kontraktori është paguar për përshpejtim) që Përfundimi faktik ndodh përpara Datës së Parashikuar të Përfundimit. Menaxheri i Projektit certifikon që Punimet janë përfunduar, megjithëse mund të mos jetë data kur ato duhet të përfundojnë.

#### 49. Pagesat Paradhënie

49.1 Punëdhënësi i bën një pagesë paradhënie Kontraktorit në shumën e **përcaktuar në KVK** brenda datës së **përcaktuar në KVK**, kundrejt sigurimit nga ana e Kontraktorit të një Garancie Bankare të Pakushtëzuar në formatin dhe nga një bankë e pranueshme për Punëdhënësin në shumë dhe valutë të barabartë me pagesën paradhënie. Garancia mbetet në fuqi derisa të jetë shlyer pagesa paradhënie, por shumën e Garancisë zvogëlohet në mënyrë progresive sipas shumës së shlyer nga Kontraktori. Për pagesën paradhënie nuk ngarkohen interesa.

49.2 Kontraktori përdor pagesën paradhënie vetëm për të paguar për Pajisje, Impiantin, Materiale dhe shpenzime mobilizimi të nevojshme në mënyrë specifike për zbatimin e Kontratës. Kontraktori tregon se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë duke i Menaxherit të Projektit siguruar kopje të faturave ose dokumenteve të tjera.

49.3 Pagesa paradhënie shlyhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat që i duhen bërë Kontraktorit sipas afateve të përqindjeve të përfunduara të Punimeve, pagesë pas pagese. Pagesa paradhënie dhe shlyerja e saj nuk merren parasysh gjatë vlerësimit të punës së bërë, Variacioneve, rregullimeve të çmimit, Rasteve të Kompensimit, Bonuseve, ose Dëmeve të Likuiduara.

## 50. Garancitë

50.1 Garancia e Performancës i sigurohet Punëdhënësit jo më vonë se data e përcaktuar në Shkresën e Pranimit dhe lëshohet në një shumë të **përcaktuar në KVK**, nga një bankë ose garantues i pranueshëm për Punëdhënësin dhe sipas denominacioneve në llojet dhe proporcionet e valutës në të cilat paguhet Çmimi i Kontratës. Garancia e Performancës është vlefshme deri në një datë 28 ditë nga data e lëshimit të Certifikatës së Përfundimit në rastin e një Garancie Bankare dhe deri në një vit nga data e lëshimit të Certifikatës së Përfundimit në rastin e një Bonoje Performance.

## 51. Ditë-Punët

51.1 Nëse aplikohen, normat e Ditë-Punës në Ofertën e Kontraktorit përdoren vetëm kur Menaxheri i Projektit ka dhënë udhëzime paraprake me shkrim për punë shtesë që do të paguhet në këtë mënyrë.

51.2 Të gjitha punimet që do të paguhet si Ditë-Punë regjistrohen nga Kontraktori në formularë të miratuar nga Menaxheri i Projektit. Çdo formular i plotësuar verifikohet dhe nënshkruhet nga Menaxheri i Projektit brenda dy ditëve nga përfundimi i punës.

51.3 Kontraktori paguhet për Ditë-Punët në varësi të marrjes së formularëve të nënshkruar të Ditë-Punëve.

## 52. Kosto e Riparimeve

52.1 Humbja ose dëmtimi i Punimeve ose Materialeve që do të bëhen e pjesë e Punimeve midis Datës së Fillimit dhe përfundimit të Periudhave të Korrigjimit të Defekteve riparohen nga Kontraktori me koston e vet, nëse humbja ose dëmtimi vjen si rrjedhojë e veprimit ose mos veprimit të Kontraktorit.

## E. Përfundimi i Kontratës

- 53. Përfundimi** 53.1 Kontraktori i kërkon Menaxherit të Projektit të lëshojë një Certifikatë të Përfundimit të Punimeve dhe Menaxheri i Projektit e lëshon atë pasi të ketë marrë vendimin se të gjitha Punimet janë përfunduar.
- 54. Marrja në Dorëzim** 54.1 Punëdhënësi merr në dorëzim Kantierin dhe Punimet brenda shtatë ditëve nga lëshimi i certifikatës së Përfundimit nga Menaxheri i Projektit.
- 55. Llogaria Përfundimtare** 55.1 Kontraktori i siguron Menaxherit të Projektit një llogari të detajuar të shumës së përgjithshme që Kontraktori konsideron si të pagueshme në kuadrin e Kontratës përpara fundit të Periudhës së Përgjegjësisë për Defektet. Menaxheri i Projektit lëshon një Certifikatë të Përgjegjësisë së Defekteve dhe certifikon pagesat përfundimtare për Kontraktorin brenda 56 ditëve nga marrja e llogarisë së Kontraktorit, nëse kjo është e saktë dhe e plotë. Nëse jo, Menaxheri i Projektit lëshon brenda 56 ditëve një program që përcakton kuadrin e korrigjimeve ose shtesave të nevojshme. Nëse Llogaria Përfundimtare përsëri nuk përmbush kërkesat pas ri-dorëzimit, Menaxheri i Projektit vendos për shumën e pagueshme ndaj Kontraktorit dhe lëshon një certifikatë pagese.
- 56. Manualët e Operimit dhe Mirëmbajtjes** 56.1 Nëse kërkohen Vizatime “siç është ndërtuar” dhe/ose manualë operimi dhe mirëmbajtjeje, Kontraktori i dorëzon ato brenda datave të **përcaktuara në KVK**.
- 56.2 Nëse Kontraktori nuk siguron Vizatimet dhe/ose manualët brenda datave të **përcaktuara në KVK** sipas Nën-Klauzolës 56.1, ose nëse ato nuk miratohen nga Menaxheri i Projektit, ky i fundit mund të mos paguajë shumën e **përcaktuar në KVK** nga pagesat që i takojnë Kontraktorit.

**57. Prishja**

57.1 Punëdhënësi ose Kontraktori mund të prishin Kontratën nëse pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

57.2 Shkeljet themelore të Kontratës përfshijnë sa vijon, por jo vetëm:

- (a) Kontraktori ndërpret punimet për 28 ditë ndërkohë që në Programin aktual nuk ka ndërprerje punimesh dhe ndërprerja nuk është autorizuar nga Menaxheri i Projektit;
- (b) Menaxheri i Projektit udhëzon Kontraktorin të vonojë ecurinë e Punimeve dhe udhëzimi nuk tërhiqet brenda 28 ditëve;
- (c) Punëdhënësi ose Kontraktori falimentojnë ose kalojnë në procedurë likuidimi, përveç se në raste rikonstruksioni ose bashkimi;
- (d) një pagesë të certifikuar nga Menaxheri i Projektit që nuk i paguhet Kontraktorit nga Punëdhënësi brenda 84 ditëve nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- (e) Menaxheri i Projektit Njofton se dështimi për të korrigjuar një Defekt të caktuar është një shkelje themelore e Kontratës dhe Kontraktori dështon në korrigjimin e Defektit brenda një afati të arsyeshëm kohor të përcaktuar nga Menaxheri i Projektit;
- (f) Kontraktori nuk mirëmban një Garanci, që është e nevojshme;
- (g) Kontraktori ka vonuar përfundimin e Punimeve me një numër ditësh, për të cilat shuma maksimale e dëmeve të likuiduara mundtë paguhet, sipas **përcaktimeve të KVK**; ose
- (h) nëse Kontraktori, në gjykimin e Punëdhënësit, është përfshirë në praktika korrupsioni, mashtrimi, marrëveshesh të fshehta, shtrënguese, ose ndaluese gjatë konkurrimit për ose zbatimit të Kontratës, atëherë Klienti mundet, pas njoftimit me shkrim katërmbëdhjetë (14) ditor, të prishë Kontratën dhe ta përjashtojë atë nga Kantieri.

57.3 Kur njëra nga palët në Kontratë njofton Menaxherin e Projektit mbi një shkelje të Kontratës për një shkak që nuk është renditur në Nën-Klauzolën 56.2 më lart, Menaxheri i Projektit

vendos nëse shkelja është themelore ose jo.

57.4 Pavarësisht nga sa më lart, Punëdhënësi mund të prishë Kontratën për shkaqe volie.

57.5 Nëse Kontrata priset, Kontraktori ndalon menjëherë punimet, e kthen Kantierin në gjendje të sigurt dhe të siguruar dhe largohet nga Kantieri sa më shpejt të jetë e mundur.

**58. Pagesa pas Prishjes së Kontratës**

58.1 Nëse Kontrata priset për shkak të një shkelje themelore të Kontratës nga Kontraktori, Menaxheri i Projektit lëshon një certifikatë për vlerën e punës së kryer dhe Materialet e porositura dhe zbret pagesat paradhënie të bëra deri në datën e lëshimit të certifikatës, si dhe përqindjen që aplikohet për vlerën e punimeve të papërfunduara, sipas **përcaktimeve në KVK**. Dëmet e tjera të Likuiduara nuk aplikohen. Nëse shumica e përgjithshme që i takon Punëdhënësit tejkalon pagesat që i takojnë Kontraktorit, diferenca bëhet borxh që i duhet shlyer Punëdhënësit.

58.2 Nëse Kontrata priset për voli të Punëdhënësit ose për shkak të një shkeljeje themelore të Kontratës nga ana e Punëdhënësit, Menaxheri i Projektit lëshon një certifikatë për vlerën e punës së kryer, Materialet e porositura, koston e arsyeshme për largimin e Pajisjeve, kthimin në atdhe të personelit të Kontraktorit të punësuar vetëm për Punimet, si dhe kostot e Kontraktorit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punimeve, duke zbritur pagesat paradhënie të kryera deri në datën e certifikatës.

**59. Prona**

59.1 Të gjitha Materialet në Kantier, Impianti, Pajisjet, Punimet e Përkohshme dhe Punimet konsiderohen si pronë e Punëdhënësit nëse Kontrata priset për shkak të Kontraktorit.

**60. Lirimi nga Kryerja e Punimeve**

60.1 Nëse Kontrata dëmtohet nga shpërthimi i luftës ose nga ngjarje të tjera tërësisht jashtë kontrollit të Punëdhënësit dhe Kontraktorit, Menaxheri i Projektit certifikon që kontrata është dëmtuar. Kontraktori e bën Kantierin të sigurt dhe ndalon punimet sa më shpejt të jetë e mundur pas marrjes së kësaj certifikate dhe paguhet për të gjithë punën e kryer përpara marrjes së saj dhe për të gjithë punën e kryer më pas, për të cilën ishte bërën angazhim.

**61. Pezullimi i  
Huasë apo  
Kredisë  
Bankare**

61.1 Në rast se Banka pezullon Huanë ose Kredinë për Punëdhënësin, nga ku bëhet një pjesë e pagesave të Kontraktorit:

- (a) Punëdhënësi është i detyruar të njoftojë kontraktorin për këtë pezullim brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit të pezullim nga Banka.
- (b) Nëse Kontraktori nuk ka marrë shumat që i takojnë brenda 28 ditëve të pagesës përcaktuar në Nën-Klauzolën 40.1, Kontraktori mund të lëshojë menjëherë një njoftim 14 ditor për prishje kontrate.





## Seksioni IX. Kushtet e Veçanta të Kontratës

Përveç se kur përcaktohet ndryshe, të gjitha KVK-të duhet të plotësohen nga Punëdhënësi përpara lëshimit të Dokumentacionit të Ofertimit. Afatet dhe raportet që duhet të sigurohen nga Punëdhënësi duhet të jepen si shtojca.

<b>A. Të Përgjithshme</b>	
<b>KPK 1.1 (d)</b>	Institucioni financiar është: <b>HUA NGA IBRD: NR. 8656- ALB</b>
<b>KPK 1.1 (s)</b>	Punëdhënësi është: Emri: <b>Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)</b> Adresa: <b>Rruga: " Sami Frashëri", Nr. 10, Tiranë</b> Tel: <b>+355 4 2235 597/8</b> Fax: <b>+355 4 2234 885</b> E-mail: <b>eqirjaqi@albaniandf.org</b> Adresa e Internetit: <a href="http://www.albaniandf.org">www.albaniandf.org</a>
<b>KPK 1.1 (v)</b>	Data e Parashikuar e Përfundimit për të gjitha Punimet është : <b>8.5 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.</b>
<b>KPK 1.1 (y)</b>	Menaxheri i Projektit është : <i>(Do te vendoset ne momentin e neneshkrimit te Kontrates)</i>
<b>KPK 1.1 (aa)</b>	Kantieri ndodhet në adresën : <b>Rruga hyrëse "Mihal Komneno" për në kala dhe Tabja - Berat</b> dhe është i përcaktuar në Vizatimet Nr. <i>[shënoni numrat]</i>
<b>KPK 1.1 (dd)</b>	Data e Fillimit është : <b>2 jave pas nenshkrimit te kontrates</b>
<b>KPK 1.1 (hh)</b>	Punimet përbëhen nga : <b>Punime civile per Rehabilitimin e rrugës hyrëse "Mihal Komneno" për në kala dhe Tabja.</b>
<b>KPK 2.2</b>	Përfundimet e Seksioneve janë: <b>" e pa aplikueshme"</b>
<b>KPK 2.3(i)</b>	Dokumentet e mëposhtme përbëjnë gjithashtu pjesë të Kontratës: <b>1. Licenca e ushtrimit te Biznesit te Operatorit Ekonomik (leshuar nga QKR)</b>

	<p><b>2. Licesa profesionale e operatorit ekonomik</b></p> <p><b>3. Licensat profesionale te stafit te operatorit ekonomik te kerkuara ne dokumentin e tenderit</b></p> <p><b>4. Policat e sigurimit</b></p> <p><b>5. Garancia e Kontrates</b></p>
<b>KPK 3.1</b>	<p>Gjuha e Kontratës është : <b>Gjuha Shqipe</b></p> <p>Ligji qe udheheq Kontratën është ligji Shqiptar.</p>
<b>KPK 5.1</b>	<p>Menaxheri i Projektit <b><i>mund</i></b> te delegojë secilën nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij.</p>
<b>KPK 8.1</b>	<p>Afatet për kontraktorët e tjerë: <b><i>“ e pa aplikueshme”</i></b></p>
<b>KPK 13.1</b>	<p>Shumat minimale të sigurimeve dhe të të zbritshmeve janë:</p> <p>(a) për humbje ose dëme të Punimeve, Impiantit dhe Materialeve: <b>“Sipas politikave dhe policave te sigurimeve te percaktuara nga ligji Shqiptar”</b></p> <p>(b) për humbje ose dëmtim të Pajisjeve: <b>Sipas politikave dhe policave te sigurimeve te percaktuara nga ligji Shqiptar”</b></p> <p>(c) për humbje ose dëme ndaj pronës (përveç Punimeve, Impiantit, Materialeve, dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën : <b>Sa vlera totale e kontrates.</b></p> <p>(d) për dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>(i) Të punonjësve të Kontraktorit: <b>“Sipas politikave dhe policave te sigurimeve te percaktuara nga ligji Shqiptar”</b>.</p> <p>(ii) Për persona të tjerë: <b>“Sipas politikave dhe policave te sigurimeve te percaktuara nga ligji Shqiptar”</b>.</p>
<b>KPK 14.1</b>	<p>Të Dhënat e Kantierit janë: <i>[rendisni të Dhënat e Kantierit]</i></p>
<b>KPK 20.1</b>	<p>Data(t) e Zotërimit të Kantierit janë: <b>Pesë dite pas neneshkrimit te kontrates</b></p>
<b>KPK 23.1 &amp; KPK 23.2</b>	<p>Autoriteti për Emërimin e “Gjykues teknik/ inxhinier civil” te pavarur : <b><i>Dhoma e Tregetise</i></b></p>
<b>KPK 24.3</b>	<p>Pagesa për orë dhe llojet e shpenzimeve të rimbursueshme që i paguhen “Gjykues teknik/ inxhinier civil”: <b>3,000 leke/ore</b></p>
<b>KPK 24.4</b>	<p>Institucioni procedura e arbitrazhit e të cilit do të përdoret:</p>

	Gjykata Administrative e Rrethit te Tiranes Vendi i arbitrazhit është: <b>Tirana</b>
<b>B. Kontrolli i Kohës</b>	
<b>KPK 26.1</b>	Kontraktori dorëzon për miratim një Program të Punimeve brenda <b>15 ditësh</b> nga data e Shkresës së Pranimit.
<b>KPK 26.3</b>	Periodha midis përditësimeve të Programit është <i>[përcaktoni numrin]</i> ditë.  Shuma që mbahet për dorëzimin me vonesë të një Programi të përditësuar është <b>0.05% e cmimit te kontrates ne dite.</b>
<b>C. Kontrolli i Cilësisë</b>	
<b>KPK 34.1</b>	Periodha e Përgjegjësisë për Defektet është: <b>365 ditë.</b>
<b>D. Kontrolli i Kostos</b>	
<b>KPK 44.1</b>	Valuta e vendit të Punëdhënësit është: <b>Leke</b>
<b>KPK 45.1</b>	Kontrata <b>“nuk është”</b> objekt i rregullimit të çmimit sipas Klauzolës 45 të KPK-ve.
<b>KPK 46.1</b>	Pjesa e mbajtur e pagesave është: <b>10%</b>
<b>KPK 47.1</b>	Dëmet e likuiduara për të gjithë Punimet janë :  <b>0.1% e Çmimit përfundimtar të Kontratës në ditë.</b>  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punimet është <b>10% e Çmimit përfundimtar të Kontratës.</b>
<b>KPK 48.1</b>	Bonusi për të gjitha Punimet është <b>“ e pa aplikueshme”</b> . Shuma maksimale e Bonusit për të gjitha Punimet është <b>“ e pa aplikueshme”</b> e Çmimit përfundimtar të Kontratës.
<b>KPK 49.1</b>	Pagesat Paradhënie janë: <b>10% e Çmimit të Kontratës</b> dhe i paguhen Kontraktorit jo më vonë se <b>30 dite pas neneshkrimit te kontrates kundrejt dorezimit te garancise bankare per parapagim, te leshuar nga nje Banke e nivelit te dyte.</b>
<b>KPK 50.1</b>	Shuma e Garancisë së Performancës është :  Garancia Bankare: <b>10% e Çmimit të Kontratës</b>

<b>E. Përfundimi i Kontratës</b>	
<b>KPK 56.1</b>	Data brenda së cilës kërkohen manualët e operimit dhe mirëmbajtjes është : <b>Brenda 60 diteve pas dates se perfundimit te punimeve.</b>  Data brenda së cilës kërkohen vizatimet “siç është ndërtuar” është <b>Brenda 2 javeve pas dates se perfundimit te punimeve</b>
<b>KPK 56.2</b>	Shuma që mbahet në rast se nuk dorëzohen vizatimet “siç është ndërtuar” dhe/ose manualët e operimit dhe mirëmbajtjes brenda datës së përcaktuar në Nën-Klauzolën 58.1 të KPK-ve është: <b>2% e Çmimit përfundimtar të Kontratës.</b>
<b>KPK 57.2 (g)</b>	Numri maksimal i ditëve është: <i>[përcaktoni numrin; në përputhje me Klauzolën 47.1 për dëmet e likuiduara].</i>
<b>KPK 58.1</b>	Përqindja që i aplikohet vlerës së punës së papërfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Punëdhënësit për përfundimin e Punimeve është <b>15 %</b>

## Seksioni X – Formularët e Kontratës

Ky Seksion përmban formularët të cilët, pasi të plotësohen, do të jenë pjesë e Kontratës. Formularët për Sigurimin e Performancës dhe Sigurimin e Pagesës Paradhënie, kur kërkohet, do të plotësohen vetëm nga Ofertuesi fitues, pas përcaktimit të fituesit të kontratës.

### Tabela e Formularëve

<a href="#"><u>Letra e Pranimit</u></a> .....	36
<a href="#"><u>Marrëveshja e Kontratës</u></a> .....	37
<a href="#"><u>Sigurimi i Performancës (Garancia Bankare)</u></a> .....	39
<a href="#"><u>Sigurimi i Performancës (Garancia e Performancës)- "Not Applicable"</u></a> .....	41
<a href="#"><u>Sigurimi i Pagesës Paradhënie (issued from a Bank)</u></a> .....	43

## Letra e Pranimi

[*në letrën me kokë të Punëdhënësit*]

..... [*data*]. .....

Drejtuar: ..... [*emri dhe adresa e Kontraktorit*]. .....

Lënda: ..... [*Njoftimi i Kontratës Fituese No*]. .....

Me anë të kësaj shkrese ju njoftojmë se Oferta juaj dt. . . [*shëno datën*]. . . për ekzekutimin e. . . . . [*shëno emrin e kontratës dhe numrin e NIPT-it, të dhënë në KVK*]. . . . . Për Shumën e pranuar të Kontratës së. . . . . [*shëno shumën në numra dhe fjalë dhe emri i valutës*], meqenëse e korrigjuar dhe modifikuar në përputhje me Udhëzimet për Ofertuesit është pranuar në këtë mënyrë nga Agjencia jonë.

Kërkohe të dorëzoni Sigurimin e Performancës brenda 28 ditësh në përputhje me Kushtet e Kontratës, duke përdorur për këtë qëllim shkresën e Formularit të Sigurimit të Performancës të përfshirë në Seksionin X. Formularët e Kontratës, së Dokumentit të Ofertës.

### [*Zgjidhni një nga deklaratat e mëposhtme:*]

Pranojmë që \_\_\_\_\_ [*shëno emrin e Gjyksesit të propozuar nga Ofertuesi*] të emërohet si Gjykses.

### [*ose*]

Nuk pranojmë që \_\_\_\_\_ [*shëno emrin e Gjyksesit të propozuar nga Ofertuesi*] të emërohet si Gjykses, dhe duke dërguar një kopje të kësaj Shkrese Pranimi për \_\_\_\_\_ [*shëno emrin e Autoritetit Emërues*], Autoritetin Emërues, i kërkojmë këtij Autoriteti të emërojë Gjyksesin në përputhje me piken 2.9 dhe GCC 23.1.

Nënshkrimi i Autorizuar: .....

Emri dhe Titulli i Nënshkruesit: .....

Emri i Agjencisë: .....

Bashkangjitur: Marrëveshja e Kontratës

## Marrëveshja e Kontratës

KJO MARRËVESHJE lidhur ..... më....., ndërmjet .... [emri i Punëdhënësit]....  
..... (më tej "Punëdhënësi"), i njëres palë, dhe..... [emri i Kontraktorit].... (më tej  
"Kontraktori"), i palës tjetër:

NDËRSA Punëdhënësi dëshiron që Punimet e njohurs si....[emri i Kontratës]... duhet të  
zbatohen nga nga Kontraktori, dhe ka pranuar një Ofertë nga Kontraktori për zbatimin dhe  
përfundimin e këtyre punimeve dhe riparimin e çdo defekti në to,

Punëdhënësi dhe Kontraktori bien dakord si më poshtë:

1. Në këtë Marrëveshje fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që u është dhënë  
respektivisht në dokumentet e përmendura të Kontratës.
2. Dokumentet e mëposhtme do të konsiderohen se përbëjnë, lexohen dhe interpretohen si  
pjesë e kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje do të ketë përparësi mbi të gjitha dokumentet e tjera  
të Kontratës.
  - (i) Shkresa e e Pranimi
  - (ii) Shkresa e Ofertës
  - (iii) Shtesa Nr \_\_\_\_\_ (nëse ka)
  - (iv) Kushtet e Veçanta
  - (v) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, përfshirë Shtojcat;
  - (vi) Specifikimet
  - (vii) Vizatimet
  - (viii) Preventivi;<sup>17</sup> dhe
  - (ix) Çdo dokument tjetër i renditur në KPP, si pjesë përbërëse e Kontratës,
3. Duke pasur parasysh pagesat që do të bëhen nga Punëdhënësi për Kontraktorin siç  
përcaktohet në këtë Marrëveshje, Kontraktori angazhohet para Punëdhënësit për të zbatuar  
punimet dhe për të riparuar defektet në të gjitha aspektet në përputhje me dispozitat e  
Kontratës.
4. Punëdhënësi angazhohet për të paguar Kontraktorin duke pasur parasysh zbatimin dhe  
përfundimin e punimeve dhe riparimin e defekteve në to, Çmimin e Kontratës apo ndonjë  
shumë tjetër që mund të paguhet sipas dispozitave të Kontratës në kohën dhe mënyrën e  
përcaktuar në Kontratë.

---

<sup>17</sup> Në kontratat me shumë të përgjithshme, fshini "Preventiv" dhe zëvendësojeni me "Afatet e Veprimtarive".



NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, palët kontraktuese kanë bërë që kjo Marrëveshje të zbatohet në përputhje me ligjet e . . . . [emri i vendit huamarrës]. . . . në ditën, muajin dhe vitin e specifikuar më sipër.

Nënshkruar  
nga: \_\_\_\_\_  
për dhe në emër të Punëdhënësit

Nënshkruar  
nga: \_\_\_\_\_  
për dhe në emër të Kontraktorit

në prani të: \_\_\_\_\_  
Dëshmitari, Emri, Nënshkrimi, Adresa, Data

në prani të: \_\_\_\_\_  
Dëshmitari, Emri, Nënshkrimi, Adresa, Data

## Sigurimi i Performacës (Garancia Bankare)

### Opsioni 1: (Garancia Bankare)

[letër me kokë e Garantuesit ose kodi identifikues SWIFT]

**Përfituesi:** [Shëno emrin dhe adresën e Punëdhënësit]

**Datë:** [Shëno datën e lëshimit]

**GARANCIA E PAGESËS PARADHËNIE Nr. :** [Shëno numrin e referencës së garancisë]

**Garantuesi:** [Shëno emrin dhe adresën e vendit të çështjes, përveç nëse tregohet në letrën me kokë]

Jemi informuar se \_ [shëno emrin e Kontraktorit, i cili në rastin e një ndërmarrjeje të përbashkët do të jetë emri i ndërmarrjes së përbashkët] (më tej i quajtur "Aplikuesi") ka lidhur Kontratën Nr. [shëno numrin e referencës së kontratës] datën [shëno datën] me Përfituesin, për zbatimin e \_ [shëno emrin e kontratës dhe një përshkrim të shkurtër të Punimeve] (më tej e quajtur "Kontrata").

Gjithashtu, e kuptojmë se, sipas kushteve të Kontratës, kërkohet një garanci performance.

Me kërkesë të Aplikuesit, ne si Garantues, në mënyrë të parevokueshme marrim përsipër për t'i paguar Përfituesit çdo shumë ose shuma që në total nuk kalojnë vlerën prej [shëno shumën në shifra] (\_\_\_\_) [shëno shumën në fjalë],<sup>18</sup> 1 shumë e cila do të paguhet në llojet dhe pjesët e valutave në të cilat është i pagueshëm Çmimi i Kontratës, pas marrjes nga ana jonë e kërkesës së pajtueshmërisë së Përfituesit mbështetur nga deklarata e Përfituesit, qoftë në vetë kërkesën ose në një dokument të veçantë të nënshkruar që shoqëron apo identifikon kërkesën, duke deklaruar se Aplikuesi është në shkelje të detyrimit (detyrimeve) të tij sipas Kontratës, pa qenë nevoja që Përfituesi të provojë apo të tregojë arsyet për kërkesën tuaj ose shumën e specifikuar në të.

Kjo garanci do të skadojë, jo më vonë se .... Dita e ....., 2 ...<sup>19</sup>, dhe çdo kërkesë për pagesë në bazë të saj duhet të pranohet nga ne në zyrën e treguar më sipër në këtë datë ose para saj.

---

<sup>18</sup> Garantuesi duhet të shënojë një shumë që përfaqëson përqindjen e Shumës së Pranuar të Kontratës specifikuar në Shkresën e Pranimit, pa shumat e përkohshme, nëse ka, dhe të shprehura ose në valutën (valutat) e Kontratës ose një monedhë lirish të konvertueshme të pranueshme për Përfituesin.

<sup>19</sup> Shënoni datën njëzet e tetë ditë pas datës së pritshme të përfundimit siç përshkruhet në Klauzolën GC 53.1. Punëdhënësi duhet të theksojë se në rast të shtyrjes së kësaj date për përfundimin e Kontratës, Punëdhënësi do të duhet të kërkojë zgjatjen e kësaj garancie nga Garantuesi. Një kërkesë e tillë duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të bëhet para datës së skadimit të përcaktuar në garanci. Në përgatitjen e kësaj garancie, Punëdhënësi mund të shqyrtojë faktin që t'i shtojë formularit tekstin në vijim, në fund të paragrafit të parafundit: "Garantuesi bie dakord për zgjatjen një herë të kësaj garancie për një periudhë që nuk tejkalon [gjashtë muaj] [një vit], në përgjigje të kërkesës me shkrim të Përfituesit për këtë zgjatje, ku një kërkesë e tillë duhet t'i paraqitet Garantuesit para skadimit të garancisë".

Kjo garanci është subjekt i Rregullave Uniforme për Garancitë e Kërkesës (URDG) 2010 Rishikim, Botimi ICC Nr. 758, përveç faktit që deklarata mbështetëse sipas Nenit 15 (a) është përjashtuar.

*[Nënshkrimi (nënshkrimet)]*

***Shënim: I gjithë teksti me shkronja kursive (përfshirë shënimet në fund të faqes) është për përdorim në përgatitjen e këtij formulari dhe do të fshihet nga produkti përfundimtar.***

## Sigurimi i Performancës (Garancia e Performancës)- "Not Applicable"

### Opsioni 2: Garancia e Performancës

Përmes kësaj Garancie, [*shëno emrin e Porositësit*] si Porositës (më tej i quajtur "Kontraktuesi") dhe [*shëno emrin e Garantuesit*] si Garantues (më tej i quajtur "Garantuesi"), lidhen fort ndaj [*shëno emrin e Punëdhënësit*] si Detyrues (më tej të quajtur "Punëdhënësi") në shumën prej [*shëno shumën në fjalë dhe shifra*], për pagesën e së cilës që duhet të realizohet plotësisht dhe realisht në llojet dhe proporcionet e valutave në të cilat paguhet Çmimi i Kontratës, Kontraktori dhe Garantuesi lidhin veten e tyre, trashëgimtarët, zbatuesit, administratorët, pasardhësit dhe personat e emëruar të tyre, bashkërisht dhe individualisht, në mënyrë të vendosur përmes këtyre dokumenteve.

NDËRSA Kontraktori ka lidhur një Marrëveshje me shkrim me Punëdhënësin më \_\_\_\_\_dita \_\_\_\_\_, 20 \_\_\_\_\_, për [*emri i kontratës dhe përshkrimi i shkurtër i Punimeve*] në përputhje me dokumentet, planet, specifikimet, dhe ndryshimet e tyre, të cilat në masën e parashikuar, janë bërë pjesë e kësaj kontrate dhe më tej referohen si Kontrata.

TASHMË, PËR RRJEDHOJË, Kushti i këtij Detyrimi është i tillë që, në rast se Kontraktori duhet menjëherë dhe me besnikëri të zbatojë Kontratën e lartpërmendur (duke përfshirë çdo ndryshim të saj), atëherë ky detyrim do të jetë i pavlefshëm; përndryshe, do të mbetet në fuqi dhe efekt të plotë. Kurdo që Kontraktori nuk do të plotësojë detyrimin, dhe shpallet nga Punëdhënësi se nuk ka plotësuar detyrimin sipas Kontratës, ndërkohë që Punëdhënësi ka kryer detyrimet e Punëdhënësit sipas saj, Garantuesi mund të korrigjojë menjëherë këtë mungesë, ose duhet menjëherë:

- (1) të përfundojë Kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e saj; ose
- (2) të marrë një Ofertë ose oferta nga Ofertues të kualifikuar për t'ia dorëzuar Punëdhënësit për përfundimin e Kontratës në përputhje me termat dhe kushtet e saj, dhe pas përcaktimit nga Punëdhënësi dhe Garantuesi i Ofertuesit më të ulët të gatshëm, të realizojë një Kontratë ndërmjet një Ofertuesi të tillë dhe Punëdhënësit dhe të vërë në dispozicion ndërkohë që puna vazhdon (edhe pse duhet të ketë një mosplotësim ose një varg mosplotësimesh të Detyrimit sipas Kontratës ose Kontratave të realizuara sipas këtij paragrafi) fonde të mjaftueshme për të paguar koston e përfundimit pa Bilancin e Çmimit të Kontratës; por pa tejkalar, duke përfshirë shpenzimet dhe dëmet e tjera për të cilat Garantuesi mund të jetë më tej përgjegjës, shumën e përcaktuar në paragrafin e parë të saj. Termi "Bilanci i Çmimit të Kontratës," siç përdoret në këtë paragraf, do të thotë shuma totale e pagueshme nga Punëdhënësi për Kontraktorin sipas Kontratës, pa shumën e paguar plotësisht nga Punëdhënësi për Kontraktorin; ose

- (3) t'i paguajë Punëdhënësit shumën e kërkuar nga Punëdhënësi për të përfunduar Kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e saj deri në një total që nuk tejkalon shumën e kësaj Garancie.

Garantuesi nuk është përgjegjës për një shumë më të madhe se dënimi i caktuar i kësaj Garancie.

Çdo padi në bazë të kësaj Garancie duhet të paraqitet para skadimit të një viti nga data e lëshimit të Certifikatës së Marrjes në Dorëzim.

Asnjë e drejtë veprimi nuk krijohet në këtë Garanci ndaj apo për përdorimin e ndonjë personi ose korporate tjetër të ndryshme nga Punëdhënësi i quajtur në këtë kontratë ose trashëgimtarët, zbatuesit, administratorët, pasardhësit, dhe personat e emëruar të Punëdhënësit.

Në dëshmi sa më sipër, Kontraktuesi ka vënë firmën dhe vulën e tij në këtë marrëveshje, dhe Garantuesi ka bërë që këto dokumente të vulosen me vulën e e tij të korporatës të vërtetuar sipas rregullave me nënshkrimin e përfaqësuesit të tij ligjor, sot më \_\_\_\_\_ 20 \_\_\_\_\_.

NËNSHKRUAR MË \_\_\_\_\_ në emër të \_\_\_\_\_

Nga \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_

Në prani të \_\_\_\_\_

NËNSHKRUAR MË \_\_\_\_\_ në emër të \_\_\_\_\_

Nga \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_

Në prani të \_\_\_\_\_

## Sigurimi i Pagesës Paradhënie (Parapagesës)

(Issued from a Bank)

[letër me kokë e Garantuesit ose kodë identifikues SËIFT]

**Përfituesi:** [Shëno emrin dhe adresën e Punëdhënësit]

**Datë:** [Shëno datën e lëshimit]

**GARANCIA E PAGESËS PARADHËNIE Nr.:** [Shëno numrin e referencës së garancisë]

**Garantuesi:** [Shëno emrin dhe adresën e vendit të çështjes, përveç nëse tregohet në letrën me kokë]

Jemi informuar se \_ [shëno emrin e Kontraktorit, i cili në rastin e një ndërmarrjeje të përbashkët do të jetë emri i ndërmarrjes së përbashkët] (më tej i quajtur "Aplikuesi") ka lidhur Kontratën Nr. [shëno numrin e referencës së kontratës] datën [shëno datën] me Përfituesin, për zbatimin e \_ [shëno emrin e kontratës dhe një përshkrim të shkurtër të Punimeve] (më tej e quajtur "Kontrata").

Gjithashtu, e kuptojmë se, sipas kushteve të Kontratës, duhet të bëhet sigurimi i pagesës paradhënie në një shumën [shëno shumën në shifra] ( ) [shëno shumën në fjalë] kundrejt një garancie pr pagesë paradhënie.

Me kërkesë të Aplikuesit, ne si Garantues, në mënyrë të parevokueshme marrim përsipër për t'i paguar Përfituesit çdo shumë ose shuma që në total nuk kalojnë vlerën prej [shëno shumën në shifra] (\_\_\_\_) [shëno shumën në fjalë],<sup>20</sup> pas marrjes nga ana jonë e kërkesës së pajtueshmërisë së Përfituesit mbështetur nga deklaratat e Përfituesit, qoftë në vetë kërkesën ose në një dokument të veçantë të nënshkruar që shoqëron apo identifikon kërkesën, duke deklaruar ose se Aplikuesi:

(a) ka përdorur pagesën paradhënie për qëllime të tjera të ndryshme nga shpenzimet e mobilizimit në lidhje me Punimet; ose

(b) nuk ka shlyer pagesën paradhënie në përputhje me kushtet e Kontratës, duke specifikuar shumën që Aplikuesi nuk ka shlyer.

Një kërkesë sipas kësaj garancie mund të paraqitet që në momentin e paraqitjes para Garantuesit të një vërtetimi nga Banka e Përfituesit ku deklarohet se pagesa paradhënie e përmendur më lart i është atribuar Aplikuesit në numrin e tij të llogarisë [shëno numrin] në [shëno emrin dhe adresën e bankës së Aplikuesit] ..

---

<sup>20</sup> Garantuesi duhet të shënojë një shumë që përfaqëson shumën Pagesës Paradhënie dhe të shprehur ose në valutën (valutat) e Kontratës ose një monedhë lirisht të konvertueshme të pranueshme për Përfituesin.

Shuma maksimale e kësaj garancie do të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma e pagesës paradhënie të shlyer nga Aplikuesi siç është specifikuar në kopjet e deklaratave të përkohshme ose vërtetimet e pagesës që do të na paraqiten. Kjo garanci do të skadojë, më së fundmi, pasi të jetë marrë nga ana jonë një kopje e vërtetimit të pagesës së përkohshme që tregon se nëntëdhjetë (90) për qind e Shumës së Pranuar të Kontratës, pa shumat e përkohshme, është vërtetuar për pagesën, ose në [shëno ditën] dita e [shëno muajin], 2 [shëno vitin],<sup>21</sup> cilado që është më herët. Rrjedhimisht, çdo kërkesë për pagesë sipas kësaj Garancie duhet të merret nga ana jonë në këtë zyrë në këtë datë ose para saj.

Kjo garanci është subjekt i Rregullores Uniforme për Garancitë Demand (URDG) 2010 Revision, ICC Botimi nr 758, përveç se deklaratën mbështetëse sipas nenit 15 (a) është i përjashtuar në këtë mënyrë.

*[Nënshkrimi (nënshkrimet)]*

***Shënim: I gjithë teksti me shkronja kursive (përfshirë shënimet në fund të faqes) është për përdorim në përgatitjen e këtij formulari dhe do të fshihet nga produkti përfundimtar.***

---

<sup>21</sup> Shënoni datën e pritshme të skadimit për Kohës për Përfundimin. Punëdhënësi duhet të theksojë se në rast të shtyrjes së kësaj date për përfundimin e Kontratës, Punëdhënësi do të duhet të kërkojë zgjatjen e kësaj garancie nga Garantuesi. Një kërkesë e tillë duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të bëhet para datës së skadimit të përcaktuar në garanci. Në përgatitjen e kësaj garancie, Punëdhënësi mund të shqyrtojë faktin që t'i shtojë formularit tekstin në vijim, në fund të paragrafit të parafundit: “Garantuesi bie dakord për zgjatjen një herë të kësaj garancie për një periudhë që nuk tejkalon [gjashtë muaj] [një vit], në përgjigje të kërkesës me shkrim të Përfituesit për këtë zgjatje, ku një kërkesë e tillë duhet t'i paraqitet Garantuesit para skadimit të garancisë”.

**Shtojca 14:** [Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike]

**1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Tel/Fax \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_  
Faqja në Internet \_\_\_\_\_

**2. Lloji i procedurës:** \_\_\_\_\_

**3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër**\_\_\_\_\_

**4. Fondi limit** \_\_\_\_\_

**5. Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin):**

Vlera \_\_\_\_\_ me Tvsh                      Monedha \_\_\_\_\_

Vlera e nenkontaktimit \_\_\_\_\_ me Tvsh                      Monedha \_\_\_\_\_

**6. Data e lidhjes së kontratës** \_\_\_\_\_

**7. Emri dhe adresa e kontraktorit/nenkontraktimit**

Emri \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Nr. NIPT \_\_\_\_\_